



Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZGJEDHJET PËR QEVERISJEN VENDORE

12 tetor 2003 - 25 janar 2004

Raport i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve¹
OSBE/ODIHR



Varshavë
25 shkurt 2004

¹ *Shënim:* Teksti në anglisht mbetet i vetmi tekst zyrtar.

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE	1
II. HYRJE DHE FALENDERIME	3
III. SFONDI POLITIK	3
IV. KUADRI LEGJISLATIV	5
V. ADMINISTRATA ZGJEDHORE	8
A. PËRBËRJA E KOMISIONEVE ZGJEDHORE	8
B. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE	9
C. LISTAT E ZGJEDHËSVE	11
VI. REGJISTRIMI I PARTIVE DHE KANDIDATËVE	13
VII. FUSHATA ZGJEDHORE	14
VIII. MEDIA	15
A. KUADRI LIGJOR	15
B. MONITORIMI I MEDIAS.....	16
IX. ANKIMET DHE APELIMET	17
X. PJESËMARRJA E GRAVE	18
XI. PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE NË PROCESIN ZGJEDHOR	19
XII. VËZHGESIT VENDORË	19
XIII. VËZHGIMI I VOTIMIT DHE NUMËRIMIT	20
A. VOTIMI.....	20
B. NUMËRIMI.....	21
C. NXJERRJA E REZULTATEVE.....	21
D. PUBLIKMI I REZULTATEVE	22
E. RINUMËRIMET.....	22
XIV. ZGJEDHJET E PËRSËRITURA	23
XV. REZULTATET E ZGJEDHJEVE	24
XVI. REKOMANDIME	25
A. KUADRI LIGJOR	25
B. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE	26
C. ANKIME T DHE APELIMET	28
D. MEDIA	28
E. PJESËMARRJA E GRAVE.....	28
F. VËZHGIMI VENDOR.....	28
RRETH OSBE/ODIHR	29

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZGJEDHJET PËR QEVERISJEN VENDORE
12 tetor 2003 - 25 janar 2004

Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve
OSBE/ODIHR
Raporti Përfundimtar

I. PËRMBLEDHJE

Republika e Shqipërisë zhvilloi më 12 tetor 2003 zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore për këshillat dhe kryetarët e bashkive dhe komunave në 65 bashki (përfshirë Tiranën), 11 njësi bashkiake të Tiranës dhe 308 komuna. Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MVZ) i OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore u ngrit si përgjigje ndaj ftesës së Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Zgjedhjet për qeverisjen vendore ishin një mundësi e humbur për një përparim domethënës drejt përmbushjes së angazhimeve të OSBE-së dhe standardeve të tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Ndërkohë që u vërejtën përmirësime të rëndësishme në zhvillimin e fushatës zgjedhore, pasqyrimin e saj në media, trajtimin e ankimeve dhe apeliemeve dhe administrimin e zgjedhjeve, procesi ishte përsëri i tejzgjatur dhe konfliktual, veçanërisht në Tiranë. Në mënyrë të veçantë, problemet gjatë numërimit të votave ishin mjaft të përhapura. Megjithatë Partia Socialiste (PS) dhe Partia Demokratike (PD) treguan një aftësi të paparë për dialog gjatë reformës së kuadrit ligjor, një vullnet më i madh politik kërkohet nga të dyja partitë për të siguruar një proces zgjedhor të efektshëm dhe të besueshëm.

Zgjedhjet u zhvilluan sipas një Kodi të ri e të përmirësuar Zgjedhor, që siguron një bazë efektive për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike. Kodi u miratua pas një pune konsensuale të një komisioni parlamentar *ad hoc* me përfaqësim shumëpartiak. Ky komision u ngrit në vijim të rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2001, me qëllim përmirësimin e kuadrit zgjedhor.

Megjithatë, ai përmban edhe dispozita në lidhje me formimin dhe funksionimin e komisioneve zgjedhore, të cilat u shfrytëzuan nga partitë kryesore politike për të bllokuar procesin e vendimmarrjes. Këto dispozita ishin fryt i një marrëveshjeje PS-PD, që kishte për qëllim të siguronte miratimin e Kodit të ri Zgjedhor nga Kuvendi.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) i administroi zgjedhjet përgjithësisht në mënyrë profesionale, transparente dhe të paanshme. Megjithatë, atij i munguan rregulla procedurale të përcaktuara qartë. Vendimet mbi një sërë çështjesh të rëndësishme u morën me vonesë. Në pak raste, veçanërisht në lidhje me zgjedhjet në Tiranë, çështje të rëndësishme nuk u trajtuan fare. Komisionet e nivelit të mesëm dhe të ulët përgjithësisht funksionuan në mënyrë të hapur. Megjithatë, kur ato u keqpërdorën nga PS-ja dhe PD-ja për të bllokuar vendime me të cilat partitë nuk qenë dakord, komisionet u bënë shumë të politizuara.

Listat e zgjedhësve vazhduan të jenë problematike. Përpjekjet për të përmirësuar saktësinë e tyre brenda një kohe të shkurtër nuk sollën rezultate thelbësore. Në ditën e zgjedhjeve, problemet u duk se ishin më të shtrira nga sa pritej dhe një numër i konsiderueshëm zgjedhësish nuk mundën të gjenin emrat e tyre në listë. Kjo ndodhi veçanërisht në Tiranë, Durrës dhe Shkodër. Megjithatë, dokumentacioni që iu dha OSBE/ODIHR-it nga PD-ja nuk e mbështeti përfundimin

se listat ishin manipuluar politikisht për të përjashtuar zgjedhësit e saj.

Fushata zgjedhore u zhvillua në një atmosferë të qetë, me një rritje të nivelit të debatit të qenësishëm mbi çështje politike dhe pa retorikën e nxehtë që kishte njollosur fushatat e mëparshme. Ishte një zhvillim i mirëpritur fakti që partitë politike, përherë e më shumë, e njihnin njëra-tjetrën si kundërshtarë të ligjshme politike dhe pati një rënie të ndjeshme të ankimeve lidhur me kërcënime dhe presione të tjera të padrejta. Për fat të keq, lëvrimi i fondeve publike publike për fushatat e partive politike u bë me vonesë. Kjo i dha përparësi partive në pushtet dhe kandidatëve me fonde private. Titullarët aktualë që rikandidonin, si nga PS-ja edhe nga PD-ja, në disa zona, duket se përfituan nga përparësitë e postit.

Qendrimi i medias elektronike u përmirësua ndjeshëm në krahasim me zgjedhjet e mëparshme. Transmetuesit kryesorë, përfshirë transmetuesin publik, TVSH, iu përmbajtën dispozitave ligjore për një pasqyrim të barazpeshuar dhe nuk pati pasqyrime agresive apo irrituese. Ndërkohë që media e shkruar ishte më agresive se ajo elektronike, ajo ishte dukshëm më e moderuar dhe e barazpeshuar se në të shkruarën.

Votimi u vlerësua pozitivisht në shumicën dërrmuese të qendrave të votimit të vizituara nga vëzhgues ndërkombëtarë, megjithëse një numër masash për sigurimin e transparecës nuk u zbatuan në mënyrë koherente. Rastet e votimit në grup dhe atij familjar ishin edhe këtë herë të shpeshta. Policia veproi në përputhje me Ligjin e ndryshuar “Për Policinë e Shtetit” dhe qendroi larg qendrave të votimit gjatë procesit të votimit, gjë që ndikoi pozitivisht në atmosferën e ditës së zgjedhjeve.

Në të kundërt, pati gabime procedurale të rëndësishme në numërimin e votave. Pësjellime dhe mosmarrveshje lidhur me vlefshmërinë e fletëve të votimit si dhe probleme të tjera serioze në plotësimin e tabelave të rezultateve u vërejtën në rreth 40 për qind të qendrave të votimit të vëzhguara. Ajo që përbën shqetësim më të madh ishte që falsifikimi i rezultateve u raportua nga vëzhguesit ndërkombëtarë në 10 për qind të numërimeve të votave të vëzhguara. Në 19 për qind të numërimeve të vëzhguara, në kutinë e votimit u gjetën më shumë fletë votimi sesa numri i zgjedhësve që kishin votuar.

Nxjerrja e rezultateve u krye përgjithësisht në mënyrën e duhur. Megjithatë, në Tiranë, probleme serioze lidhur me përmbajtjen, procedurën, administrimin si dhe bllokimi që u krijua, vonuan përfundimin e procesit. Kjo, për rrjedhojë, çoi në një vendim të Kolegjit Zgjedhor për të përsëritur zgjedhjet në një të tretën e qendrave të votimit në qytet.

Zgjedhjet u desh të përsëriteshin edhe në disa njësi të tjera të qeverisjes vendore dhe për rrjedhojë, procesi nuk u mbyll para datës 20 shkurt 2004, kur KQZ-ja shpalli rezultatet përfundimtare. Ndonëse kishte dallim të madh në mënyrën se si u zhvilluan zgjedhjet e përsëritura, në disa qendra votimi u vëzhguan shkelje flagrante.

Sistemi i përmirësuar i ankimit dhe apelimit i parashikuar nga Kodi i ri Zgjedhor përgjithësisht funksionoi mirë, por mund të ishte përdorur më efektivisht nga partitë politike dhe kandidatët. Kolegji Zgjedhor funksionoi në mënyrë efikase, megjithëse në disa raste nuk arriti të kryente hetime të mjaftueshme në lidhje me ankimet.

Ndër zhvillimet pozitive, mund të përmendet ai që procesi zgjedhor çoi në një kalim të rregullt të pushtetit në njësitë e qeverisjes vendore në mbarë vendin, përfshirë edhe disa njësi ku ky

kalim nuk pritej dhe që asnjë organ i sapozgjedhur i qeverisjes nuk u bojkotua.

OSBE/ODIHR-i mbetet i gatshëm të ndihmojë autoritetet dhe shoqërinë civile të Republikës së Shqipërisë për të vazhduar përmirësimin e procesit të saj zgjedhor. Në këtë këndvështrim, është thelbësor trajtimi i menjëhershëm i mangësive të vërejtura në këto zgjedhje, për të qenë të përgatitur në kohë për zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Duke patur parasysh problemet e vazhdueshme të vullnetit politik, OSBE/ODIHR-i rithekson rëndësinë e një procesi përfshirës dhe konsensual të reformës së kuadrit zgjedhor. Për të ndihmuar këtë proces, ky raport përfshin një sërë rekomandimesh, ndërsa një vlerësim i hollësishëm i Kodit Zgjedhor do të publikohet së shpejti nga OSBE/ODIHR-i, në bashkëpunim me Komisionin e Venecias të Këshillit të Evropës.

II. HYRJE DHE FALENDERIME

Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i OSBE/ODIHR-it, i kryesuar nga Ambasadori Robert L. Barry (SHBA), nisi punën më 10 shtator 2003 dhe qëndroi në Shqipëri deri më 24 tetor 2003. Njëzet e nëntë ekspertë për zgjedhjet dhe vëzhgues afatgjatë nga 19 shtete anëtare të OSBE-së u vendosën në kryeqytet dhe në qendrat e shtatë qarqeve.

Në ditën e zgjedhjeve, me MVZ-në e OSBE/ODIHR-it u bashkua një delegacion i Kongresit të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Evropës i Këshillit të Evropës (KAVRE), i kryesuar nga Znj. Helene Lund (Danimarkë), duke formuar Misionin Ndërkombëtar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MNVZ). Një numër i përgjithshëm prej 220 vëzhguesish nga 25 shtete anëtare të OSBE-së u vendosën si vëzhgues afatshkurtër nga OSBE/ODIHR-i për ditën e zgjedhjeve, bashkë me nëntë vëzhgues nga KAVRE. Vëzhguesit ndërkombëtarë vizituan 1064 nga 4684 qendra votimi në Shqipëri.

Si rrjedhojë e një numri të lartë rinumërimesh dhe zgjedhjesh të përsëritura, procesi zgjedhor vijoi edhe në vitin 2004. Ndonëse MVZ-ja e mbylli zyrtarisht misionin e vet më 24 tetor 2003, OSBE/ODIHR-i vazhdoi të monitorojë me vëmendje procesin nga Varshava si dhe me anë të vizitave në Shqipëri në muajt nëntor dhe dhjetor. Përsëritja e zgjedhjeve më 28 dhjetor 2003 u monitorua nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, mbështetur nga OSBE/ODIHR-i dhe u vëzhgua nga KAVRE.

OSBE/ODIHR-i dëshiron të shprehë vlerësimin e tij për Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, autoritetet e tjera dhe organizatat e shoqërisë civile, si dhe misionet diplomatike dhe organizatat ndërkombëtare në vend për bashkëpunimin dhe ndihmesën e tyre gjatë atij që vërtetoi të ishte një proces i gjatë e kompleks. Bashkëpunimi nga ana e KQZ-së ishte i shkëlqyer dhe meriton të përmendet në mënyrë të veçantë.

OSBE/ODIHR-i dëshiron të falenderojë, gjithashtu, Prezencën e OSBE-së në Shqipëri për mbështetjen e saj të gjerë si dhe për organizimin e monitorimit të zgjedhjeve të përsëritura dhe procesit të zgjatur të ankimeve dhe apelimeve.

III. SFONDI POLITIK

Që prej vitit 1991, politika në Shqipëri ka qenë tejet e polarizuar, me dy partite politike mbizotëruese, PS dhe PD, që konkurronin për pushtet si në nivel kombëtar ashtu edhe atë

vendor. PS-ja, e udhëhequr nga Kryeministri Fatos Nano, ka mbajtur pushtetin në nivel kombëtar që nga viti 1997, megjithëse ka patur krisje në parti në të gjitha nivelet. Dr. Sali Berisha vazhdoi të udhëheqë PD-në pasi kjo e fundit humbi pushtetin në 1997, ndonëse edhe kjo parti ka patur pjesën e e saj të çarjeve dhe largimeve.

Si rezultat i kësaj atmosfere të polarizuar, zgjedhjet e vëzhguara nga OSBE/ODIHR-i në Shqipëri që nga viti 1992, përgjithësisht, nuk kanë arritur të përmbushin angazhimet e OSBE-së dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, edhe pse OSBE/ODIHR-i ka vërejtur përmirësime graduale. Megjithatë, procesi ka qenë përgjithsisht konfliktual dhe i tejzgjatur, me pretendime për parregullsi dhe mashtrime, disa prej të cilave janë dokumentuar nga komuniteti ndërkombëtar. Partia që nuk arrinte të fitonte zgjedhjet në nivel vendor apo kombëtar, përgjithësisht, refuzonte të pranonte si legjitim rezultatit e zgjedhjeve, duke ju drejtuar shpesh bojkotit të organeve të zgjedhura ose kërcënimeve me bojkot. Kjo atmosferë minoi besimin publik tek zgjedhjet dhe institucionet demokratike.

Mbështetja e jashtëzakonshme politike në Shqipëri për integrim më të afërt me institucionet Euro-Atlantike, në veçanti me Bashkimin Evropian (BE) dhe NATO-n, premtonte ta zbuste këtë tendencë. Në janar të vitit 2003, BE-ja vendosi të hapte negociatat zyrtare me Qeverinë Shqiptare për Marrëveshjen e Stabilizim dhe Asocimit, hapi i parë ky në rrugën drejt pranimit në BE. Sipas marrëveshjes, kërkohet një përparim i dukshëm në reformën institucionale, luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe në forcimin e qeverisjes në nivel qendror dhe vendor. Në prag të zgjedhjeve për qeverisjen vendore, të gjitha figurat dhe partitë politike kryesore shprehën publikisht vendosmërinë e tyre për të zhvilluar me sukses zgjedhjet për qeverisjen vendore 2003.

Në këtë kontekst, në shkurt 2002 filluan përmirësime të jashtëzakonshme në marrëdhëniet politike, kur Prezenca e OSBE-së në Shqipëri udhëhoqi negociatat midis PS-së dhe PD-së për fillimin e një procesi dypalësh reforme. Në përgjigje të Raportit Përfundimtar të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet e vitit 2001, u gjet një zgjidhje për ngritjen e një komisioni parlamentar *ad hoc* “bi-partizan” për reformën zgjedhore, bashkëkryesuar nga PS-ja dhe PD-ja dhe me përfaqësim të të gjitha partive parlamentare. Komisioni nisi nga puna në maj 2002 me mandatin për të hetuar parregullsitë e së shkuarës dhe për të rishikuar kuadrin legjislativ për zgjedhjet. Procesi politik që mbështeste marrëveshjet mbi reformën u përforcua më tej nga zgjedhja me konsensus e Presidentit të Republikës në qershor 2002.

Me përfundimin e punës së tij në prill 2003, komisioni bi-partizan kishte trajtuar pjesën më të madhe të rekomandimeve të Raportit Përfundimtar të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare të vitit 2001.¹ Komisioni pati ndihmesën e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, në rolin e lehtësuesit të procesit, me ekspertizë të dhene nga OSBE/ODIHR-i dhe Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës. Ky proces, pothuajse pa konflikte, si dhe qendrimi konsensual i mishëruar në dy bashkëkryetarët, ishin në kontrast të dallueshëm me përpjekjet e mëparshme për reformë zgjedhore dhe hapën një kapitull të ri në dialogun politik shqiptar dhe në praktikën parlamentare.²

¹ Komisioni bi-partizan funksionoi sipas rregullash të veçanta votimi. Amendamentet u miratuan me konsensus të plotë, në pothuajse të gjitha rastet, në përputhje me formulën e vendimmarrjes, që kërkonte si shumicë të thjeshtë, ashtu edhe konsensusin e dy partive kryesore.

² Disa parti të vogla kundërshtuan në komisionin bi-partizan vetëm për formatin e fletëve të votimit, listat shumëemërore, dispozitën për ndërhyrjen e KQZ-së për të sqaruar emra të paqartë të partive, si dhe ishin pro barazisë strikte sesa asaj porcionale në shpërndarjen e minutazhit falas për fushatën zgjedhore në media.

Me afrimin e fushatës zgjedhore, niveli i konsensusit filloi të ulet. Megjithatë, në qershor 2003, Kuvendi miratoi Kodin e ri Zgjedhor. Ky Kod u bazua kryesisht mbi marrëveshjen e arritur nga komisioni parlamentar “bi-partizan”, por përmbante edhe dispozita të rëndësishme, veçanërisht, lidhur me përbërjen e KQZ-së dhe formimin e komisioneve të niveleve më të ulëta, bazuar në marrëveshje të veçanta midis PS-së dhe PD-së.³ Partitë e vogla politike i kundërshtuan këto dispozita të mbështetura në marrëveshjen PS-PD, me arsyetimin se ato favorizonin vetëm PS-në dhe PD-në. Megjithatë Kodi i ri u mirëprit nga udhëheqësit e PS-së dhe PD-së dhe nga komuniteti ndërkombëtar si një zhvillim pozitiv, u pranua gjerësisht se legjislacioni i ri do të kishte nevojë të rishqyrtohej dhe rishikohej nën dritën e përvojës së nxjerrë nga zgjedhjet për qeverisjen vendore.

Pak përpara zgjedhjeve për qeverisjen vendore, një çarje e re ndodhi në PS-në në pushtet, me dorëheqjen e Ministrit të Punëve të Jashtme, Ilir Meta, ish-Kryeministër socialist. Zëvendësimi i propozuar nga Kryeministri Nano u kundërshtua nga një votë në Kuvend, një ngjarje e pa precedent e shfrytëzuar nga kundërshtarët e qeverisë Nano. Pëveç kësaj, emërimi i anëtarëve të KQZ-së, vonesa në shpërndarjen e fondeve partive politike dhe roli i policisë në ditën e zgjedhjeve u bënë çështje polemikash midis partive politike kryesore. Kështu, fushata për zgjedhjet vendore nisi kundrejt një sfondi rivalitetesh të rigjallëruara.

IV. KUADRI LEGJISLATIV

Kodi i ri Zgjedhor përmirësoi kuadrin ligjor për zgjedhjet dhe trajtoi pjesën më të madhe të rekomandimeve që përmbante Raporti Përfundimtar i OSBE/ODIHR-it për Zgjedhjet Parlamentare 2001.⁴ Ky Kod, së bashku me ligje të tjera, përfshirë Kushtetutën dhe udhëzime shtesë të KQZ-së, u konsiderua nga OSBE/ODIHR-i si një bazë efektive për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike.⁵

Një karakteristikë qendrore e Kodit të ri është ngritja *de facto* e një administrate zgjedhore, në të cilën anëtarët e komisioneve zgjedhore propozohen nga katër parti politike, në rastin konkret, Partia Socialiste, Partia Demokratike, Partia Socialdemokrate dhe Partia Republikane.⁶ Sipas Kodit të mëparshëm Zgjedhor, Komisionet Zgjedhore të Qeverisjes Vendore (KZQV-të) dhe Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV-të) përbëheshin nga përfaqësues të shtatë partive me numrin më të madh të votave të marra në zgjedhjet e fundit për qeverisjen vendore. Dispozitat e Kodit të ri Zgjedhor për emërimin e anëtarëve të komisioneve përdorin një kombinim të përfaqësimit parlamentar me rezultatin e përgjithshëm proporcional në shkallë kombëtare për zgjedhjet e fundit për pushtetin vendor.

³ Marrëveshjet PS-PD u konkretizuan në dy protokolle të nënshkruara në maj 2003. Këto protokolle i angazhuan nënshkruesit të trajtonin çështjet kyçe të financimit të fushatës, rindarjes së zonave zgjedhore dhe sistemit zgjedhor pas zgjedhjeve vendore 2003.

⁴ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë është Ligji Nr. 9087, datë 19 qershor 2003.

⁵ Kjo pjesë e raportit synon të japë vetëm një vështrim të shkurtër mbi disa prej pjesëve më të rëndësishme të Kodit dhe nuk ka për synim dhe as duhet interpretuar si një vlerësim zyrtar ose analizë e plotë e Kodit. Gjithashtu, pamundësia për të komentuar mbi një dispozitë të veçantë të Kodit nuk duhet interpretuar si pranim i dispozitës. Për më tepër, komentet në këtë pjesë të raportit lidhen kryesisht me dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me zgjedhjet për qeverisjen vendore.

⁶ Nga 50 partitë e regjistruara për zgjedhjet, vetëm 39 paraqitën kandidatë ose lista shumëemërore. Njëmbëdhjetë parti u zgjodhën në Kuvend në zgjedhjet e fundit parlamentare.

Roli mbizotërues i PS-së dhe PD-së në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore u përforcua nga dispozitat e miratuara nga PS-ja e PD-ja, të cilat kërkonin që vendime të rëndësishme të merren me shumicë të cilësuar prej dy te tretash, domethene, pesë nga shtatë vota, si dhe kërkesën që vendimet të nënshkruhen si nga kryetari ashtu edhe nga nënkryetari, të cilët në rrethanat aktuale politike janë përfaqësues të PS-së e PD-së. Këto dispozita krijuan një mundësi të madhe për bllokimin e funksionimit të komisioneve zgjedhore. Në praktikë, partitë politike, shpesh, emëruan aktivistë partiakë në komisione, ku ata vepruan në mënyrë shumë të politizuar, duke bllokuar vendime me të cilat ata nuk ishin dakord, pavarësisht nga vlerat e tyre.⁷

Çështja e anëtarësisë së KQZ-së u bë, gjithashtu, një çështje polemikash edhe para fillimit të periudhës së fushatës zgjedhore për një sërë arsyes. Së pari, dispozitat në Kodin e ri Zgjedhor për emërimin e anëtarëve të KQZ-së u dhanë PS-së e PD-së kontroll *de facto* mbi emërimet. Së dyti, këto dispozita mund të jenë në kundërshtim me Kushtetutën në kufizimin e tepruar që vendosin në të drejtën e tri organeve emëruese (Kuvendi, Presidenti dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë). Së treti, Kodi Zgjedhor nuk arrin të përcaktojë në mënyrë të qartë ato parti politike që kanë të drejtë ligjore të propozojnë anëtarë të KQZ-së si dhe të komisioneve zgjedhore te niveleve më të ulëta, por, përkundrazi, përdor një terminologji të vagët që përpiket të përshkruajë ideologjitë me peshë politike aktuale.

Dispozitat e reja nuk sigurojnë një kuadër efektiv apo të qëndrueshëm për caktimin e anëtarësisë në KQZ dhe në komisionet zgjedhore të niveleve më të ulëta. Në themel, komisionet zgjedhore duhet të jenë organe përgjegjëse për administrimin efikas të një procesi zgjedhor që është përfshirës, transparent dhe i pavarur nga avantazhet politike. Kuadri i ri mund ta garantojë këtë vetëm në prani të një vullneti të mjaftueshëm politik për të respektuar votën popullore dhe ligjin.

Një çështje tjetër madhore në Kodin e ri Zgjedhor është metoda e përditësimit të listave të zgjedhësve, që, për një kohë të gjatë, ka qenë problem në zgjedhjet në Shqipëri. Vendimi i Kuvendit për të mos miratuar dispozitat kalimtare për zgjedhjet e 2003-shit, të miratuara nga komisioni bi-partizan, detyroi KQZ-në të plotësojë boshllëkun legjislativ me një udhëzim bazuar mbi Kodin e mëparshëm dhe të nxjerrë ndërkohë që ky i fundit ishte ende në fuqi. Sistemi i përdorur për përditësimin e listës së zgjedhësve ishte në një masë të madhe ai i Kodit të mëparshëm. Megjithatë, KQZ-ja mori miratimin e përfaqësuesve të partive politike për të gjitha procedurat e rishikimit të listave të zgjedhësve.

Disa nga problemet madhore të vërejtura gjatë zgjedhjeve të mëparshme nuk janë trajtuar në mënyrë të mjaftueshme nga dispozitat përkatëse të Kodit të ri. Në mënyrë të veçantë, Kodi i ri u lejon partive politike, ashtu si dhe individëve të paraqesin një kërkesë për të shtuar ose hequr emrin e një zgjedhësi nga listat paraprake të përgatitura nga KZQV-të. Në praktikë, kjo çoi në paraqitjen e listave të gjata me emra pa patur prova bindëse, të cilat KZQV-të i patën shumë të vështira t'i verifikonin. Dispozita e mirëpritur e Kodit të ri, e cila kërkon që çdo zgjedhës të njoftohet për qendrën e votimit ku ai ose ajo është regjistruar për të votuar, nuk u zbatua në 12 tetor.⁸ Megjithatë, Kodi është i paqartë mbi funksionimin e kësaj procedure. Autoritetet

⁷ Nje koment joformal i paraqitur në Komisionin Parlamentar të Ligjeve nga një ekspert i lartë ligjor i OSBE/ODIHR-it, para miratimit të ligjit në qershor 2003, ngriti shqetësime rreth votimit me shumicë të cilësuar dhe shtimit të kërkesave për nënshkrim, duke shprehur se ato "hedhin bazat për bllokim, pengesë dhe pamundësi për të marrë vendimet e nevojshme gjatë zgjedhjeve" dhe duke treguar se kanë përforcuar mundësinë që procesi zgjedhor të ishte përsëri i tejzgjatur, konfliktual, i fragmentuar dhe i pasigurt.

⁸ KQZ-ja, me ndihmën e Fondacionit Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore (IFES), u shpërndau zgjedhësve njoftime me shkrim dhe harta të zonave të qendrave të votimit para përsëritjes së pjesëshme të zgjedhjeve në Tiranë më 28 dhjetor,

zgjedhore u mjaftuan thjesht me nxitjen e zgjedhësve për ta gjetur vetë ku do të votonin.

Një përmirësim i rëndësishëm në Kodin e ri është futja e një procesi ankimi dhe apelimi që siguron një procedurë më të thjeshtuar dhe më transparente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore. Më parë, kuadri ligjor parashikonte që subjektet zgjedhore të prekura të mund të kërkonin zgjidhje kundër pretendimeve për shkelje në procesin zgjedhor nëpërmjet rrugësh të ndryshme ligjore. Kjo krijonte pështjellim dhe lejonte konfliktualitet të tejzgjatur. Kodi i ri përcakton një rrugë të vetme hierarkike për kundërshtimin e vendimeve të komisioneve zgjedhore dhe zgjidhjen e tyre brenda afatesh të qarta. Vendimet e KQZ-së mund të apelojnë në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për të siguruar koherencë në gjykimin e mosmarrëveshjeve zgjedhore.

Megjithëse Kodi i ri përmirësoi procesin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore, disa mangësi mbeten. Afatet për vendimet mbi apelimet nga KQZ-ja dhe Kolegji Zgjedhor mund të jenë ngjeshur në mënyrë jorealiste dhe konfliktojnë me dispozitat e Kodit Administrativ dhe Kodit të Procedurës Civile, të cilat parashikojnë që palëve në një mosmarrëveshje t'u jepet kohë e mjaftueshme për të mbledhur dhe paraqitur prova. Zbatimi i këtyre dispozitave të Kodit Administrativ dhe Kodit të Procedurës Civile çoi në vonimin e vendimeve mbi apelimet dhe, si pasojë, në fund të fushatës u grumbullua një numër i madh ankimesh. Në mënyrë të kuptueshme KQZ-ja e pati të vështirë të përballej me këto raste brenda afateve. Për më tepër, përgjithësisht, pati një ngurrim nga partitë politike për t'u mbështetur në procedurat e reja, ku ankimet shpesh adresoheshin në mënyrë jofomale në mbledhjet e KQZ-së ose nëpërmjet medias, në vend që të paraqisnin dokumentacionin zyrtar pranë organit përkatës.

Kodi mund të përmirësohet duke përfshirë rregullime të hollësishme për financimin e fushatës, si dhe duke kërkuar raportimin dhe bërjen publike të kontributeve. Së bashku me mangësi të ngjashme në Ligjin "Për Partitë Politike," kjo çoi në një kuadër ligjor që nuk arrin të sigurojë transparencën për financimin dhe shpenzimet e partive politike për fushatën. Për ta ilustruar këtë, Kodi nuk përmban dispozita ligjore që të kërkojnë bërjen publike të kontributeve private dhënë kandidatëve individualë për kryetar bashkie ose komune për zgjedhjet.

Gjithashtu, një shqetësim të veçantë përbëjnë ato dispozita të Kodit që rregullojnë modelin e fletës së votimit dhe përcaktimin e vlefshmërisë së fletës së saj. Sipas nenit 90, fleta e votimit përbëhet nga dy pjesë të veçanta dhe zgjedhësi ka një votë për secilën pjesë të fletës së votimit. Mungesa e rregullave të qarta për mënyrën se si numërohen votat, veç e veç në secilën fletë votimi, çoi në probleme serioze gjatë numërimit. KQV-të, shpesh, nuk dinin si të vepronin me ato fletë votimi ku një votë ishte shënuar në mënyrë të vlefshme në një pjesë të fletës së votimit, por jo në tjetrën.⁹

Mungesa e koherencës në nenet 91 dhe 109 përbën, gjithashtu, një problem të rëndësishëm lidhur me vlefshmërinë e votës. Neni 91 shprehet se mosnënshkrimi i fletës e votimit nga kryetari ose nënkryetari i KQV-së nuk e vonon procesin e votimit. Megjithatë, sipas Nenit 109 paragrafi (1)(dh)(i), fleta e votimit konsiderohet e "parregullt" nëse mungon ndonjë nga nënshkrimet e kërkuara. Kjo presupozon se, megjithëse zgjedhësit do t'i jepet një fletë votimi e panënshkruar, që procesi të mos vonohet, fleta e votimit në fund të fundit, do të përcaktohet e pavlefshme ("e parregullt"). T'i japësh një zgjedhësi një fletë votimi që, më vonë, do të

gjë që pakësoi pështjellimin në ditën e zgjedhjeve.

⁹ Vëzhguesit e MNVZ-së vërejtën se, në qendrat e votimit ku ata ishin të pranishëm, kjo kontribuoi që një përqindje relativisht e lartë (deri në 15%) e fletëve të votimit, të deklaroheshin e pavlefshme.

përcaktohet si e pavlefshme është si t'i mohosh zgjedhësit të drejtën e votës.

Procedurat për numërimin e votave të parashikuara nga Kodi Zgjedhor janë të ndërlikuara në mënyrë të panevojshme dhe lejojnë një kohë tepër të gjatë për dërgimin e rezultateve nga një qendër votimi në KZQV-në përkatëse. Kodi, gjithashtu, parashikon procedura të paqarta dhe të pazbatueshme në praktikë për hartimin e tabelave të rezultateve nga ana e KZQV-ve. Megjithëse publikimi i hershëm dhe i plotë i rezultateve nga qendrat e votimit është teknikisht i realizueshëm dhe do të siguronte një kontribut më të madh në transparencën e procesit zgjedhor, nuk ka ndonjë kërkesë ligjore që detyron KZQV-të apo KQZ-në të nxjerrë rezultatet paraprake. Ligji duhet të kërkojë që KZQV-të dhe KQZ-ja të nxjerrin rezultate paraprake të ndara për qendër votimi sa më shpejt që të tjetër e mundur. Kryetari i KQZ-së këmbënguli që të miratohej një udhëzim për shpalljen e hershme të rezultateve, por kjo u hodh poshtë nga disa parti politike. Kodi përmban, gjithashtu, dispozita të paqarta që rregullojnë rinumërimet e votave, si dhe shumë terma dhe përkufizime jokoherente dhe të paqarta.

V. ADMINISTRATA ZGJEDHORE

Në Shqipëri ka një administratë zgjedhore me tre nivele: KQZ-ja, 384 Komisione Zgjedhore të Qeverisjes Vendore (KZQV) në bashki dhe komuna dhe 4688 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV).¹⁰ Të gjitha komisionet përbëhen nga shtatë anëtarë me të drejtë vote, dhe një sekretar pa të drejtë vote. Secila parti politike dhe koalicion që merr pjesë në zgjedhje ka të drejtën të ketë një përfaqësues pa të drejtë vote në mbledhjet e të gjitha komisioneve zgjedhore, ndërsa kandidatëve për kryetarë u lejohet një përfaqësim i ngjashëm në mbledhjet e KZQV-ve dhe KQV-ve. Këta përfaqësues kanë të drejtë të paraqesin dhe diskutojnë propozime në mbledhjet e komisionit zgjedhor.

A. PËRBËRJA E KOMISIONEVE ZGJEDHORE

Kodi i ri Zgjedhor paraqiti një formulë të re për emërimin e anëtarëve të komisioneve zgjedhore. Bazuar mbi protokoll-marrëveshjen e majit 2003 midis PS-së e PD-së, formula përpiket të sigurojë që asnjë forcë e vetme mbizotëruese, të mos ketë kontroll mbi administratën zgjedhore, duke krijuar një “barazpeshë” numerike në çdo komision. Në zgjedhjet e mëparshme, ka patur raste të shumta ku komisionet zgjedhore kanë vepruar në mënyrë shumë të politizuar, veçanërisht, në favor të titullarëve që kandidonin.

Për fat të keq, formula PS-PD është problematike për disa arsye. Së pari, ajo duket se shkel nenin 154 të Kushtetutës së Shqipërisë që rregullon emërimin e anëtarëve të KQZ-së. Së dyti, ul së tepërmi numrin e partive politike të përfaqësuara në komisione. Së treti, bashkë me kërkesën e re për votimin 5:2 dhe nënshkrimin e dyfishtë për të gjitha vendimet e rëndësishme të marra nga komisionet zgjedhore, u jep PS-së e PD-së të drejtë vetoje *de facto* mbi çdo çështje të rëndësishme. Shpërdorimi i të drejtës së vetos, në mungesë të një vullneti të mjaftueshëm politik nga të dy krahët për të respektuar votën popullore dhe ligjin, doli se ishte një problem madhor.

Bazuar në nenin 154 të Kushtetutës, shtatë anëtarët e KQZ-së emërohen nga Kuvendi (dy anëtarë), Presidenti (dy anëtarë) dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë (tre anëtarë). Kodi i ri Zgjedhor

¹⁰ Për zgjedhjet parlamentare, Komisioni i Zonës Zgjedhore (KZZ) harton tabelën e rezultatit të marrë nga KQV-të dhe ia kalon rezultatit KQZ-së

e vë procesin e propozimit të kandidaturave për këto shtatë emërtesa nën kontrollin e partive politike në përputhje me përfaqësimin në Kuvend. Ky proces përbën shqetësim, pasi kufizon numrin e kandidatëve nga të cilët tre institucionet kushtetuese mund të përzgjedhin.¹¹

Për shkak të përbërjes aktuale të kuvendit, procesi i emërimit bën të mundur që PS-ja e PD-ja të kontrollojnë zgjedhjen e dy të emëruarve prej Kuvendit, megjithëse ligji kërkon që ato të propozohen nga partitë e vogla parlamentare, një nga “spektri i majtë” dhe tjetri nga “spektri i djathtë”. Gjithashtu, Këshillit të Lartë të Drejtësisë i kërkohet të emërojë një anëtar nga PS-ja dhe një anëtar nga PD-ja nga një listë me jo më shumë se dy emra, të paraqitur përkatësisht nga PS-ja dhe nga PD-ja. Dy të emëruarit nga Presidenti duhet të vijnë nga kandidatura të dhëna nga PS-ja e PD-ja. I emëruari i tretë i Këshillit të Lartë të Drejtësisë duhet të zgjidhet nga një listë e shkurtër kandidatësh konsensualë që gëzojnë miratimin si të PS-së ashtu edhe të PD-së.

Formula e re për emërimin dhe balancimin e KQZ-së u zbatua vetëm pjesërisht për këto zgjedhje, për shkak të vazhdimin të mandatit të katër prej anëtarëve të KQZ-së të emëruar sipas legjislacionit të mëparshëm. Nga tre anëtarët e KQZ-së të emëruar rishtazi, një prej tyre u emërua nga Kuvendi nga një kandidaturë formale nga partitë e vogla të djathta dhe një nga Presidenti nga kandidaturat e paraqitura nga PD-ja, duke rivendosur kështu përfaqësimin e opozitës në KQZ. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me argumentin se nuk kishte dispozita kalimtare për të rregulluar procesin e balancimit të komisionit, emëroi anëtarin e tretë të ri me propozim të PS-së. PD-ja pretendoi se kjo KQZ ishte e njëanshme në favor të qeverisë dhe shprehu publikisht se nuk kishte besim në paanshmërinë e KQZ-së.

Procedurat e emërimit për anëtarët e KZQV-ve u përcaktuan nga një formulë e re e ngjashme në Kodin Zgjedhor. Nga shtatë anëtarë, PS-ja e PD-ja kishin të drejtën të propozonin për emërim nga dy anëtarë secila. PSD-ja dhe PR-ja u përfaqësuan, gjithashtu, me nga një anëtar secila, duke patur parasysh se Kodi Zgjedhor parashikonte përfaqësimin për dy partitë politike që zinin përkatësisht vendin e dytë në nivel kombëtar, si nga krahu i “majtë” edhe ai “i djathtë” në zgjedhjet vendore të vitit 2000. Përveç kësaj, PS-ja kishte të drejtë të propozonte për emërim anëtarin e shtatë në gjysmën e KZQV-ve, kurse PD-ja e kishte këtë të drejtë për gjysmën tjetër. Një formulë identike u ndoq për emërimin e anëtarëve të KQV-ve.

Kodi Zgjedhor përcakton, gjithashtu, një procedurë të ngjashme për të caktuar kryetarët e KZQV-ve dhe KQV-ve. E drejta për të emëruar kryetarin i përkiste të njëjtës parti politike që kishte propozuar për të emëruar anëtarin e shtatë, ndërkohë që partia tjetër politike gëzonte të drejtën të propozonte për emërim nënkryetarit dhe sekretarit e komisionit.¹²

KQZ-ja hodhi një short publik për emërimin e anëtarëve të shtatë dhe kryetarëve të KZQV-ve për PD-në e PS-në.¹³ Të gjitha palët e interesuara pranuan rezultatet dhe vlerësuan procesin, në kontrast të dallueshëm me konfliktin që kishte shoqëruar më parë zgjedhjet për këto poste.

B. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

¹¹ Dispozitat përkatëse të Kodit kufizojnë zgjedhjen e kandidaturave nga ana e institucioneve kushtetuese me të drejtë emërimi, në një listë me jo më shumë se dy kandidatë. Kështu, lista mund të përmbajë vetëm një emër.

¹² KQZ-ja ndërhyri me propozim të PD-së me një udhëzim që i jepte të drejtën për të propozuar sekretarin partisë së cilës i takonte posti i nënkryetarit.

¹³ Përbërja e KQV-ve pasqyron strukturën e anëtarësisë së KZQV-së përkatëse.

Në rolin e vet mbikqyrës në tërësi, KQZ-ja ishte, përgjithësisht, e mirëorganizuar dhe funksionoi në mënyrë të hapur dhe transparente. Bashkëpunimi me MVZ-në ishte i shkëlqyer. Pavarësisht nga polemikat rreth pretendimeve për mungesën e balancimit politik midis shtatë anëtarëve të tij, KQZ-ja funksionoi në një mënyrë, përgjithësisht, të paanshme gjatë periudhës parazgjedhore, me prova të pakta shprehjeje të njëanshmërisë. Administrata e KQZ-së ishte e pavarur dhe përgjithësisht profesionale, pavarësisht nga mungesa e përvojës së disa prej anëtarëve kyç të personelit. KQZ-ja miratoi disa risi për përmirësimin e procesit zgjedhor, duke përfshirë kuti votimi më të sigurt, siç rekomandohej në Raportin Përfundimtar të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare të vitit 2001. Për përsëritjen e pjeshme të zgjedhjeve në Tiranë më 28 dhjetor, zgjedhësit u njoftuan individualisht për qendrën e votimit ku duhej të votonin dhe përdorimi i telefonave celularë u ndalua në qendrat e votimit dhe në KZQV-të gjatë procesit të numërimit dhe nxjerrjes së rezultateve.

Megjithatë, efikasiteti i KQZ-së dhe komisioneve zgjedhore të nivelit të dytë dhe të tretë u kompromentua ndjeshëm nga vonesat në procesin e vendimmarrjes së KQZ-së. Vendimet për miratimin e regjistrimit të kandidatëve, vendndodhja e qendrave të votimit dhe rishikimi i listave të zgjedhësve u morën të gjitha më vonë se afatet e përcaktuara nga Kodi Zgjedhor. Për më tepër, një pjesë e mirë e vendimeve të KQZ-së lidhur me ankimet dhe apëlimet kundër pretendimeve për shkelje zgjedhore u shtynë më tej dhe u trajtuan pasi u kishte kaluar afati i lejuar prej tri ditësh siç e kërkon Kodi.

Vendimet për disa udhëzime procedurale të një rëndësie të veçantë u morën po ashtu tepër vonë. Udhëzimet për procedurat e votimit, të cilat ishin tashmë të shprehura qartë në Kodin Zgjedhor, u miratuan më pak se dhjetë ditë para zgjedhjeve, duke vonuar përgatitjen dhe shpërndarjen e materialeve të trajnimit. Për më tepër, udhëzimi i KQZ-së për numërimin e votave nuk u miratua deri tre ditë para zgjedhjeve. KQZ-ja, gjithashtu, nuk arriti të trajtonte një sërë çështjesh me rëndësi kyçe, ku udhëzimet ishte e qartë që ishin të nevojshme. Veçanërisht, megjithëse ishin ngritur nga një numër pjesëmarrësish në proces, përfshirë MVZ-në, KQZ-ja shpërfilli çështjen e procedurave që duheshin ndjekur për dërgimin e rezultateve nga KQV-të tek KZQV-të në Tiranë, ku u zhvilluan dy gara të veçanta zgjedhore. Ky mosveprim shkaktoi pësjtjellim të konsiderueshëm dhe vonesa në periudhën paszgjedhore.

Faktori kryesor që ndikoi në vonesat në procesin e vendimmarrjes së KQZ-së ishte mënyra se si zhvilloheshin mbledhjet e saj. Ndërsa dhënia e të drejtës për të qenë të pranishëm gjithë përfaqësuesve pa të drejtë vote të partive politike rriti transparencën e procesit zgjedhor, kjo bëri nga ana tjetër që mbledhjet e KQZ-së të zgjateshin në mënyrë të papranueshme për shkak të diskutimeve politike, shpesh për çështje që nuk ishin në rendin e ditës. Mungesa e rregullave të qarta procedurale për KQZ-në çuan në një mungesë të tillë disipline. Për arsye të papërcaktuara, një përpjekje e kryetarit të KQZ-së për të përcaktuar rregulla më të qarta procedurale u bllokua nga anëtarët e KQZ-së që përfaqësonin partitë e opozitës.

Në pjesën më të madhe, administrimi i zgjedhjeve nga KZQV-të, gjithashtu, u krye në mënyrë të hapur dhe kolegiale. Megjithatë në tërësi, KZQV-të vepruan në mënyrë pasive dhe, në shumicën e rasteve, nuk arritën t'iu përmbahen afateve ligjore për rishikimin e listave të zgjedhësve dhe caktimin e qendrave të votimit. Në pak raste, KQZ-ja gjobiti KZQV-të që nuk arritën t'iu përmbaheshin afateve. Në mënyrë të ngjashme, shumë KZQV ngurruan të ndërhyjnë në mosmarrëveshje zgjedhore, ose të vendosnin për pretendime për shkelje dhe prireshin t'i drejtonin ankimet drejtpërdrejt në KQZ për zgjidhje, pa marrë një vendim formal. Kërkesa që sekretari i KZQV-së të jetë jurist i kualifikuar u zbatua në mënyrë jo të njëtrajtshme dhe rezultoi

se ishte e vështirë të zbatohet në zonat rurale. Disa sekretarë të KZQV-ve ishin haptazi të njëanshëm dhe, në një numër të vogël rastesh, sekretari i KZQV-së ishte, gjithashtu, edhe kandidat për postin vendor. Pothuajse të gjitha KZQV-të u ankuan se u ishin dhënë fonde të pamjaftueshme nga KQZ-ja.

Me afrimin e ditës së zgjedhjeve, disa nga KZQV-të pushuan së funksionuari për shkak të mosmarrëveshjeve midis anëtarëve sipas përkatësive politike. KQZ-ja ishte e prirur të mos ndërhynte në këto mosmarrëveshje, duke presupozuar se ato do të zgjidheshin nga udhëzimet e shtabeve të partive politike. Në shumë raste ndodhi ashtu, por në dy prej tyre, një gjë e tillë nuk u arrit dhe votimi nuk u zhvillua ditën e zgjedhjeve. Ky problem vazhdoi edhe gjatë ripërsëritjes së zgjedhjeve pas 12 tetorit.

Shumë prej anëtarëve të KQV-ve u caktuan me vonesë nga KZQV-të, kryesisht, për shkak të vonesave në paraqitjen e kandidaturave nga katër partitë politike që gëzonin të drejtën e përfaqësimit. Në përputhje me të drejtat e tyre, sipas Kodit Zgjedhor, disa parti politike zëvendësuan kandidaturat e tyre pas emërimit si anëtarë komisioni. Kjo kufizoi mundësinë për të siguruar trajnim për anëtarët e KQV-ve mbi përgjegjësitë e tyre, dështim ky që u përkeqësua nga shpërndarja me vonesë nga KQZ-ja e materialeve informative, përfshirë kopje të Kodit Zgjedhor, udhëzime të KQZ-së dhe udhëzues zyrtarë për procedurat e votimit dhe numërimit. Në shumicën e rasteve, këto u morën nga anëtarët e KQV-së jo më herët se pragu i zgjedhjeve.

Në tërësi, anëtarët e KZQV-ve dhe KZZ-ve nuk kishin njohuri të mjaftueshme as mbi Kodin e ri Zgjedhor dhe as mbi udhëzimet e KQZ-së. Shumë prej tyre e kryenin këtë detyrë për herë të parë dhe zbatonin një ligj të ri me të cilin patën shumë pak kohë për t'u familjarizuar. Për më tepër, shumë anëtarë komisionesh u dhanë përparësi udhëzimeve të partive politike që i kishin emëruar sesa Kodit. Fatkeqësisht, e drejta e partive politike për të propozuar anëtarët e komisioneve nuk u shoqërua nga një shkallë e mjaftueshme bashkëpunimi dhe mbështetjeje për trajnimin përgjithësisht të mirë, të ofruar nga KQZ-ja në bashkëpunim me mbështetjen ndërkombëtare.

Për këto zgjedhje u përdor një model i ri i diskutueshëm fletësh votimi. Fleta e votimit ishte e ndarë në dy pjesë, një për secilin konkurim. Kjo shkaktoi pështjellim në ditën e zgjedhjeve, me një numër të madh votash të deklaruara të pavlefshme. Në një fazë të vonë të procesit, KQZ-ja nxori udhëzime kufizuese në lidhje me atë se çfarë do të konsiderohej votë e vlefshme. Mosmarrja në konsideratë e problemit praktik të futjes të fletëve të mëdha të votimit në kutitë e reja të votimit solli si nevojë shpërndarjen e kutive shtesë të votimit në orët e vona të votimit në ditën e zgjedhjeve. Votimi u desh të ndërpritej në një numër të kufizuar qendrash votimi, gjë që mund të ketë ndikuar në pjesëmarrjen në votime në këto qendra. Po kështu, KQZ-ja nuk arriti të hartonte procedura që do të lehtësonin votimin në Tiranë, ku u përdorën dy kuti votimi dhe dy fletë votimi pa dallim të qartë ngjyrash nga njëra-tjetra.

C. LISTAT E ZGJEDHËSVE

Listat e pasakta të zgjedhësve kanë qenë një shqetësim në të gjitha zgjedhjet në Shqipëri të vëzhguara nga OSBE/ODIHR-i, pavarësisht nga një larmi përpjekjesh për të zgjidhur problemet. Neglizhenca administrative, si dhe mosraportimi nga ana e qytetarëve, disa herë i qëllimtë, për ndryshime të gjendjes së tyre civile në regjistrat përkatës të gjendjes civile ka ndikuar negativisht në saktësinë e këtyre të fundit, të cilët përbëjnë bazën e listave paraprake të zgjedhësve. Përveç kësaj, migrimi i brendshëm dhe emigracioni intensiv ka rënduar më tej

gjendjen. Mungesa gjerësisht e përhapur e adresave, veçanërisht në qytetet kryesore si Tirana, Durrësi, Vlora dhe Shkodra, e ndërlikon procesin e verifikimit të së drejtës për të votuar të zgjedhësit. Bashkimi ose ndarja e zonave të qendrave të votimit krijon pështjellim, kur zgjedhësit nuk njoftohen që qendra e votimit në të cilën ishin caktuar ka ndryshuar. Pothuajse në çdo zgjedhje, partitë politike opozitare kanë akuzuar partitë në pushtet për manipulim të listave të zgjedhësve në avantazh të këtyre të fundit.

Ndërkohë që përpjekje dhe burime të konsiderueshme u përdorën për të përmirësuar listat e zgjedhësve, mungesa e një vizioni të qartë për një zgjidhje afatgjatë dhe vullneti politik për të nisur një proces të vështirë për hartimin dhe zbatimin e një strategjie afatgjatë, kanë rezultuar në probleme të përsëritura. Në mungesë të procedurave të shëndosha administrative, disa qindra mijëra emra janë lëvizur ose fshirë nga lista e zgjedhësve që nga vitit 2000, bazuar mbi numërime dhe/ose verifikime derë më derë nga ana e ekipeve shumëpartiake.

Projekte të mbështetura nga komuniteti ndërkombëtar janë zbatuar me qëllim zhvillimin e një regjistri kombëtar zgjedhësish të kompjuterizuar. Në një tryezë të rrumbullakët organizuar në dhjetor 2002, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të partive politike, OSBE/ODIHR-it dhe Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, u pranua nga të gjitha partitë politike, përfshirë PS-në dhe PD-në, se, ndërkohë që përditësimi i listës së zgjedhësve të vitit 2001 duhet të vazhdonte, vetëm përmirësime të kufizuara do të ishin të mundura të arriheshin para zgjedhjeve për qeverisjen vendore të vitit 2003, por që regjistrat e gjendjes civile duhej të ishin burim i vetëm i listave të zgjedhësve në sistemin e ardhshëm, i cili atëherë pritej të zbatohet në kohë për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të vitit 2005. Megjithatë, pavarësisht nga kjo marrëveshje dhe konsultime të gjera të KQZ-së me parti politike mbi procesin e rishikimit, listat e zgjedhësve mbetën përsëri një burim polemikash në këto zgjedhje.

Në Kodin e ri, përgjegjësia përfundimtare për miratimin e listave paraprake të zgjedhësve i takon KZQV-së, ndërkohë që KQZ-ja është përgjegjëse për të mbikqyrur KZQV-të dhe autoritetet e njësisve vendore ndërkohë që ato rishikojnë listat. Sipas Kodit Zgjedhor, listat paraprake të zgjedhësve duhet të bëhen publike. Vetë zgjedhësit, partitë politike dhe “institucione të tjera të interesuara” lejohen të kërkojnë shtimin ose heqjen e emrave nga listat. Apelimet ndaj vendimeve të KZQV-së mbi këto kërkesa shqyrtohen nga gjykata e shkallës së parë, e cila duhet të marrë një vendim brenda dy ditësh. Vendimi i gjykatës është i formës së prerë.

Nga fillimi i fushatës, u bë i dukshëm fakti që listat e zgjedhësve do të ishin një çështje qendrore debati. Në njësitë zgjedhore kryesore të kontestuara si Tirana, Durrësi dhe Shkodra, PD-ja paraqiti lista që kishin me qindra ose mijëra emra të zgjedhësve “të tyre”, emrat e të cilëve nuk figuronin në listat e dhëna nga zyrat e gjendjes civile. Shpesh, PS-ja kundërpërgjigjej me listat e veta. Zakonisht, këto lista paraqiteshin në KZQV pa u shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar nga ligji. Shumë KZQV nuk e kishin idenë se si ta trajtonin këtë problem. KQZ-ja i udhëzoi KZQV-të të dërgonin ekipe shumëpartiake për të verifikuar derë më derë nëse zgjedhësit vërtet banonin në njësitë zgjedhore ku pretendonin partitë. Ky ishte një proces që konsumoi shumë kohë, me një besueshmëri të diskutueshme dhe KQZ-ja zgjodhi të shpërfillte afatin për përfundimin e listave paraprake të zgjedhësve. Në disa raste, rishikimi i listave të zgjedhësve vazhdoi deri në prag të zgjedhjeve, pavarësisht nga përpjekjet e KQZ-së për të bindur KZQV-të se duhej të merrnin vendime për listat brenda afateve.

Në disa raste, vendimet e KZQV-ve mbi listat e zgjedhësve u apelian, kryesisht nga PD-ja. Megjithatë, me disa përjashtime, këto apeline nuk u adresuan në gjykatën e shkallës së parë, siç

e parashikon ligji, por iu drejtuan KQZ-së, MVZ-së ose medias.

Në ditën e zgjedhjeve, problemet me listat e zgjedhësve ishin më të gjera nga sa pritej, duke patur parasysh masën e përpjekjeve dhe burimeve të shpenzuara në vitet e fundit për përmirësimin e tyre. Një numër i konsiderueshëm zgjedhësish zbuluan se nuk figuronin në listat e qendrave të votimit ku ata pretendonin se kishin votuar në të shkuarën, ose se nuk ishin regjistruar askund. Duke reaguar ndaj pretendimeve të PD-së se mund të provonte që listat ishin manipuluar politikisht me qëllim përjashtimin e mbështetësve të saj, MVZ-ja ra dakord të shqyrtonte çdo provë të paraqitur para mbylljes së Misionit më 24 tetor. Pas shqyrtimit të një sërë dokumentesh të paraqitura nga PD-ja, MVZ-ja arriti në përfundimin se listat e zgjedhësve vazhdonin të kishin probleme serioze, por nuk arriti në përfundimin se listat e zgjedhësve kishin qenë të manipuluar politikisht.

Në reagim të ankimeve të mëtejshme bërë pranë Drejtorit të OSBE/ODIHR-it, Ambasadorit Christian Strohal, gjatë një takimi me Dr. Berishën në Vienë më 7 nëntor, një ekip i dytë, i kryesuar nga një Këshilltar i Lartë për Zgjedhjet i OSBE/ODIHR-it, i cili është ekspert në regjistrimin e zgjedhësve, bëri një vizitë në Tiranë më datat 18-26 nëntor. Ekipi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga PD-ja, i kërkoi asaj, KQZ-së dhe organeve të tjera përkatëse informacione shtesë dhe zhvilloi një testim në kampion për të vlerësuar vlefshmërinë e pretendimit për manipulim politik. PD-ja paraqiti, gjithashtu, dokumentacion shtesë pas kësaj vizite. Asnjë prej dokumentave të paraqitura nga PD-ja, në secilin rast, nuk ndryshoi përfundimin fillestar të MVZ-së.

Problemet me listat e zgjedhësve, përpilimi i hartave të zonave të qendrave të votimit dhe njoftimi individual i zgjedhësve për qendrën e votimit ku ishin caktuar për të votuar janë sjellë në mënyrë të pandërprerë në vëmendjen e autoriteteve shqiptare dhe janë theksuar nga çdo MVZ i OSBE/ODIHR-it që prej vitit 1997. Megjithatë, autoritetet shqiptare nuk kanë marrë veprime të mjaftueshme në këtë drejtim. Këto probleme kërkojnë një zgjidhje të plotë afatgjatë më tepër sesa përpjekjet e copëzuara dhe me hope, por të kushtueshme, të bëra deri tani. Pra, është përgjegjësi e qeverisë të ndërmerre veprime të menjëhershme për të siguruar se modernizimi dhe reformimi i sistemit të shërbimit të gjendjes civile do të përfundojë shpejt dhe në mënyrë efikase. Është thelbësore që një përmirësim domethënës në cilësinë e inputit të zyrave të gjendjes civile në listat e zgjedhësve të sigurohet në kohë për zgjedhjet e ardhshme

VI. REGJISTRIMI I PARTIVE DHE KANDIDATËVE

Rreth 1750 kandidatë u regjistruan për garën *first-past-the-post* [me mazhorancë të thjeshtë] për 384 mandatet e kryetarëve. Tridhjetë e nëntë parti politike, përfshirë këtu edhe një koalicion, u regjistruan nga KQZ-ja për të marrë pjesë në garën proporcionale për këshillat e bashkive dhe komunave, të cilat së bashku paraqitën mbi 4516 lista shumëëmërore të miraturara nga KZQV-të e veçanta.¹⁴

Kuadri ligjor për regjistrimin e kandidatëve dhe partive politike për të marrë pjesë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore është relativisht i qartë dhe i thjeshtë. Kandidatët dhe listat kërkojnë nënshkrimet mbështetëse nga 50 deri në 300 zgjedhës, në varësi të madhësisë të bashkisë apo komunës, në mënyrë që kandidatura e tyre të miratohet nga KZQV-ja përkatëse.

¹⁴ Koalicioni përbehej nga PD, Partia Republikane dhe Partia Bashkimi Liberal.

Bëhet përjashtim për kryetarët që janë në detyrë, këshilltarët e pavarur dhe ato parti tashmë të përfaqësuara në Kuvend ose këshilla bashkiakë apo komunalë. I mirëpritur si përmirësim në Kodin e ri Zgjedhor, afati për regjistrim në kete Kod tashmë i paraprin fillimit të fushatës zyrtare.

Ndryshe nga zgjedhjet e mëparshme, ku procesi i regjistrimit shkaktoi polemika për natyrën e vet shpesh të njëanshme, regjistrimi i kandidatëve dhe partive politike, përgjithësisht, ishte i rregullt dhe pati një rënie të dukshme të numrit të ankimeve ndaj vendimeve të KZQV-ve. Si një hap pozitiv i paparashikuar nga Kodi Zgjedhor, procesi i regjistrimit për çdo konkurim u shqyrtua nga KQZ-ja si pjesë e përgjegjësisë së saj në lidhje me përgatitjen dhe shtypjen e fletëve të votimit. Megjithëse kjo shkaktoi vonesë në shpalljen zyrtare të kandidatëve dhe të listave të partive, kjo kontribuoi në arritjen e një procesi regjistrimi më pak polemik. Pak ankesa u paraqitën në KQZ në lidhje me refuzimin nga ana e KZQV-ve për të regjistruar një kandidat ose listë partie dhe të gjitha ato u trajtuan në përputhje me ligjin.

VII. FUSHATA ZGJEDHORE

Një përmirësim i dukshëm në atmosferën e fushatës për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore u vu re në krahasim me zgjedhjet e mëparshme në Shqipëri. Një zhvillim i rëndësishëm ishte mungesa e retorikës së nxehtë midis kandidatëve dhe partive politike dhe një zvogëlim i ndjeshëm i numrit të ankimeve lidhur me kërcënime dhe presione të tjera të padrejta. Fushata u zhvillua përgjithësisht në një mënyrë të qetë dhe të rregullt, me një rritje në nivelin e debatit të qenësishëm më shumë për çështje politike sesa sulme personale. Mosmarrëveshjet në periudhën parazgjedhore u trajtuan në një mënyrë të matur dhe përfshirëse, ku Presidenti i Shqipërisë dhe KQZ-ja luajtën një rol konstruktiv.

Pavarësisht nga natyra vendore e zgjedhjeve, shumica e fushatave partiake u fokusuan në çështje me karakter kombëtar dhe u mbizotëruan nga kryetarët e partive. Në nivel vendor, vëzhguesit e MVZ-së raportuan se, ndërsa disa kandidatë dhe parti politike theksonin çështje vendore, pjesa më e madhe e fushatave bazohet mbi akuzat për korrupsion të kundërshtarit. Fushata që tërhoqi vëmendjen më të madhe ishte padyshim ajo për kryetarin e Bashkisë së Tiranës.

Financimi publik i fushatave për partitë politike të regjistruara u lëvrua vetëm në javën e tretë të fushatës. Vonesa u shkaktua nga dështimi i qeverisë për të përcaktuar dhe miratuar fondet për t'u shpërndarë nga KQZ-ja, kohë përpara fillimit të fushatës. Shumë degë të partive politike informuan vëzhguesit e MVZ-së se nuk kishin marrë absolutisht asnjë fond. Për rrjedhojë, partitë në pushtet si dhe kandidatët që kishin financime private, patën avantazhe domethënëse mbi kandidatët e tjerë. Partitë e vogla të opozitës pretendojnë se vonesa ishte e qëllimshme dhe se kufizoi mundësitë e tyre për të bërë fushatë. Disa kandidatë, shumë prej të cilëve biznesmenë, financuan vetë fushatën e tyre ose u mbështetën fuqimisht mbi kontribute private.

Ndërkohë që partitë politike janë të detyruara të bëjnë publike burimet dhe përdorimin e fondeve për fushatë, ligji nuk parashikon ndonjë kërkesë që çdo kandidat të japë llogari publikisht.

Shumë ankesa u morën për titullarët kandidatë se shfrytëzonin postin publik për të nxjerrë përfitime për fushatat e tyre. Gjithashtu, partitë e opozitës pretenduan se PS-ja përfitoi gjerësisht nga kontrolli mbi qeverisjen qendrore për të mbështetur fushatat e kandidatëve të saj. Vëzhguesit e MVZ-së raportuan disa incidente ku titullarët kandidatë duket se përfituan nga

postet publike. Kjo, përgjithësisht, lidhej me përdorimin e ndërtesave dhe transportit, si në avantazh të PS-së, ashtu edhe të PD-së.

VIII. MEDIA

Spektri i gjerë i medias së shkruar dhe asaj elektronike në Shqipëri siguroi një pasqyrim të gjerë të këtyre zgjedhjeve dhe sfondit të tyre më të gjerë politik, duke u dhënë zgjedhësve informacione të hollësishme dhe komente të ndryshme mbi kandidatët dhe partitë politike, veprimtari të fushatës zgjedhore dhe punën e administratës zgjedhore. Në ndryshim nga zgjedhjet e mëparshme, të karakterizuara nga një mbulim agresiv dhe i njëanshëm i medias, toni dhe cilësia e pasqyrimin, veçanërisht nga televizioni publik, u përmirësuan në mënyrë të ndjeshme.

A. KUADRI LIGJOR

Përmirësimet në Kodin Zgjedhor përcaktuan një kuadër të ri për pasqyrimin e fushatës zgjedhore në median elektronike. Për të gjitha partitë politike të regjistruara për të marrë pjesë në zgjedhje, u garantua minutazh falas në televizionin publik, TVSh. Shpërndarja e kohës në dispozicion për partitë u bë nga KQZ-ja, në raport me forcën aktuale parlamentare të secilës parti, ndërkohë që partitë joparlamentare morën një minutazh krahasimisht më të vogël. Disa parti të vogla u ankuan pranë MVZ-së se një interpretim kufizues i një dispozite të paqartë të Kodit Zgjedhor nga ana e KQZ-së kishte kufizuar në mënyrë të padrejtë raportin e minutazhit të transmetimit të caktuar për to, por vendimi nuk u apelua.

Kodi Zgjedhor parashikon, gjithashtu, për të gjithë transmetuesit televizivë, publikë dhe privatë, detyrimin për t'iu siguruar kohë të barabartë dhe të barazpeshuar të gjitha partive politike, përsëri, bazuar në forcën e tyre parlamentare. Për të siguruar një barazpeshë të mëtejshme, pasqyrimi në televizion i çfarëdo veprimtarie të qeverisë me ndikim të mundshëm në fushtatë u llogarit brenda minutazhit të caktuar për titullarin kandidat të PS-së. Rreptësia e dispozitave të reja u kritikua nga transmetuesit televizivë dhe u ngritën shqetësime se ndalimi i komenteve editoriale brenda edicioneve të lajmeve kufizonte lirinë e shtypit.

Si pjesë e rolit të saj të ri për mbikqyrjen e përputhjes së veprimtarisë së medias me Kodin Zgjedhor, KQZ-ja ngriti një Bord të Monitorimit të Medias (BMM), i përbërë nga shtatë anëtarë, gjashtë prej të cilëve të emëruar nga PS-ja, PD-ja, PR-ja dhe PSD-ja dhe me kryetar të emëruar nga Avokati i Popullit. BMM-ja u ngarkua të këshillonte KQZ-në për të gjitha çështjet në lidhje me median dhe iu kërkua të kryente monitorimin e pasqyrimin të fushatës për identifikimin e shkeljeve të mundshme dhe këshillimin për vendosjen e sanksioneve. Ndonëse puna e BMM-së u pengua nga burimet e kufizuara dhe vonesat në emërimin e anëtarëve dhe personelit, përsëri BMM-ja arriti të veprojë, përgjithësisht, në mënyrë efikase, gjë që nxiti transmetuesit të respektonin kërkesat ligjore.

Në mënyrë konstruktive, KQZ-ja, bazuar në sugjerimin e BMM-së, kërkoi shmangien e shkeljeve me anë të një qendrimi aktiv, duke i dhënë transmetuesve “paralajmërimet jozyrtare”, nëpërmjet të cilave kërkoheshin ndryshime në pasqyrimin e fushatës. Këto paralajmërimet u morën parasysh në pjesën më të madhe të rasteve dhe nuk u vendos asnjë sanksion. Sidoqoftë, natyra partiake e emërimeve në BMM kompromentoi aftësinë e saj për të funksionuar si një trup i vetëm, ose për të vepruar si një organ këshillimor i specializuar. Për më tepër, raportimet e saj

në KQZ ndërpriteshin dhe zgjateshin rregullisht nga ndërhyrjet e partive politike.

Në Shqipëri veprojnë disa transmetues lokalë dhe, në përpjekje për të ushtruar veprimtarinë e tyre në përputhje me rregullimet për median, secilës KZQV iu kërkua në mënyrë jorealiste të krijonte versionin e vet vendor të BMM-së. Në fund, asnjë prej tyre nuk u arrit të krijohej me sukses, pjesërisht për arsye të vonësave në emërimin e BMM-së, por edhe për shkak të mungesës së burimeve teknike të përshtatshme. Megjithatë, baza ligjore për mbikqyrjen e medias nga KZQV-të, veçanërisht pushteti i tyre për vendosjen e sanksioneve, është e paqartë.

Pasqyrimi i fushatës zgjedhore nga media e shkruar nuk është i rregulluar me ligj.

B. MONITORIMI I MEDIAS¹⁵

Pasqyrimi i fushatës zgjedhore nga media elektronike u përmirësua në mënyrë të ndjeshme si në krahasim me zgjedhje të mëparshme në Shqipëri, ashtu edhe në lidhje me standardet përkatëse ndërkombëtare për median në zgjedhje demokratike. Në përgjithësi, toni i pasqyrimin ishte i barazpeshuar dhe faktik, me një mungesë të plotë të raportimeve agresive apo irrituese. Transmetimet televizive u mbizotëruan nga pasqyrimet e veprimtarive të PS-së e PD-së, gjë që siguronte barazpeshë, por që solli si pasojë pakësimin e vëmendjes ndaj partive të tjera politike. Debatet televizive në veçanti, përgjithësisht, përfshinin vetëm mbështetësit e dy partive kryesore.

Përveç sigurimit të minutazhit falas për partitë politike, siç kërkohet nga ligji, transmetuesi publik TVSh, ka siguruar, gjithashtu, një nivel proporcionalisht të barabartë pasqyrimi gjatë edicionit qendror të lajmeve dhe analizave (PD 24%, PS 22%, parti të tjera 34%, qeveria 20%), me një ton transmetimi kryesisht pozitiv ose asnjënjës. Dy transmetuesit privatë të monitoruar nga MVZ-ja bënë, gjithashtu, një pasqyrim përgjithësisht të barazpeshuar (*TV Klan*: PD 47%, PS 32%, parti të tjera 14%, qeveria 7%; *TV Arbëria*: PD 31%, PS 27%, parti të tjera 30%, qeveria 12%). Disa gazetarë kanë raportuar raste në të cilat partitë politike janë përpjekur të ushtrojnë ndikim në pasqyrimin e veprimtarive të tyre. MVZ-ja verifikoi se një transmetues vendor, *TV Rozafa* në Shkodër, shpërndau një listë me tarifa që do të zbatoheshin ndaj partive politike për pasqyrimin e veprimtarive të tyre gjatë fushatës në emisionin e lajmeve, duke shkelur haptazi ligjin.

Media e shkruar ishte më agresive dhe negative në krahasim me atë elektronike. Gjithsesi, ndonëse pasqyrimi shpesh prirej drejt polemikave dhe sensacionit, ai ishte dukshëm më i moderuar krahasuar me zgjedhjet e mëparshme. Gazetat siguronin një hapësirë më të gjerë për opiniononet dhe pikëpamjet e ndryshme sesa televizioni, veçanërisht, në pasqyrimin e garave dhe fushatave vendore. Megjithëse media e shkruar prirej të mbante qëndrime të njëanshme, pasqyrimi i përgjithshëm ishte i barazpeshuar, por përsëri i mbizotëruar nga aktorët kryesorë (PD 31%, PS 34%, parti të tjera 17%, qeveria 18%).

Disa media shkelën heshtjen zgjedhore prej 48 orësh të parashikuar nga Kodi Zgjedhor, kryesisht duke pasqyruar konferenca shtypi të thirrura nga partitë politike dhe kandidatët për të denoncuar pretendimet për parregullsi në procesin e votimit, por që, shpesh, përfshinin

¹⁵ MVZ-ja, nga 12 shtatori deri më 10 tetor kreu monitorimin e fushatës zgjedhore në tre televizione kombëtare (televizionin publik TVSH dhe ato private TV Klan dhe TV Arbëria) dhe shtatë gazeta të përditshme private (Albania, Gazeta Shqiptare, Koha Jonë, Shekulli, Korrieri dhe Panorama).

propagandë zgjedhore.

IX. ANKIMET DHE APELIMET

Sistemi i ri i ankimeve dhe apelimeve parashikuar në Kodin e ri Zgjedhor, përgjithësisht, funksionoi mirë në rastet kur u përdor. Megjithatë, koncepti i paraqitjes së një ankimi formal duket se nuk është pranuar ose kuptuar gjerësisht nga partitë politike dhe kandidatët në periudhën parazgjedhore. Partitë politike u prirën t'ia adresojnë ankimet joformalisht komunitetit ndërkombëtar ose drejtpërdrejt KQZ-së, pavarësisht nëse ankimi ishte brenda sferës së përgjegjësisë së saj. MVZ-ja, vazhdimisht, nxiti përdorimin e procedurave të përshtatshme, veçanërisht, kur, në kontrast të mirëpritur me zgjedhjet e mëparshme, pati më pak pretendime për njëanshmëri të gjyqtarëve dhe anëtarëve të komisioneve zgjedhore gjatë periudhës së fushatës.

Para ditës së zgjedhjeve, KQZ-së iu paraqitën relativisht pak ankime dhe apelime. Pati vonesa në kohën brenda së cilës KQZ-ja trajtoi ankimet dhe apelimet, shpesh, për shkak të mungesës së dokumentacionit të duhur për të provuar pretendimet. Kjo, zakonisht, bëri të nevojshëm kërkimin e një dokumentacioni mbështetës, gjë që çoi në shtyrjen e afateve për gjykimin e ankimit për të mundësuar një proces të rregullt. Vonesa të mëtejshme u shkaktuan nga ndërhyrje të bëra rregullisht nga partitë në mbledhjet e KQZ-së për shqyrtim ankimesh.

Megjithatë, ankimet u trajtuan, përgjithësisht, nga KQZ-ja në mënyrë të drejtë dhe transparente dhe shumë pak vendime të KQZ-së u apeluan në Kolegjin Zgjedhor të sapongritur pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Ato vendime që u apeluan u gjykuan nga Kolegji Zgjedhor në mënyrë të shpejtë dhe të efektshme, ndërkohë që u ruajtën parimet e procesit të rregullt ligjor.

KQZ-ja mori 455 ankime dhe apelime lidhur me pretendime për parregullsi në ditën e zgjedhjeve dhe gjatë procesit paszgjedhor. Këto ankime, në përgjithësi, lidheshin me shpërndarjen e vendeve në këshilla, kërkesa për rinumërim apo pavlefshmëri të rezultateve për qendra të veçanta votimi dhe vonesa në nxjerrjen e rezultateve. Pavarësisht nga numri i madh i ankimeve dhe apelimeve, KQZ-ja ndërmori procedura paraprake verifikimi që kërkonin një kohë të gjatë, kryesisht, për të parë nëse nevojitej informacion shtesë, për të konfirmuar përlllogaritjet e shpërndarjes së mandateve, ose për të bashkuar apelime të ndryshme në lidhje me të njëjtin ankim.

Me raste, KQZ-së dukej se i mungonte vullneti për të përdorur plotësisht kompetencat e saj hetimore të dhëna nga Kodi. Megjithatë, në raste të tjera, si ato lidhur me dorëzimin e materialeve zgjedhore në Tiranë dhe parregullsitë në Himarë, KQZ-ja bëri përpjekje të konsiderueshme për të hetuar mbi pretendimet. Mbledhjet e KQZ-së, ku këto çështje u diskutuan, u tejzgjatën përsëri nga ndërhyrjet e partive dhe, në disa raste, vendime të rëndësishme u morën me votim 5:2, duke nxjerrë në pah një qëndrim më të njëanshëm nga anëtarë të KQZ-së.

Rreth 100 vendime të KQZ-së në periudhën paszgjedhore u apeluan në Kolegjin Zgjedhor. Këto apelime lidhur me vendime të KQZ-së për rinumërim votash, përsëritje të zgjedhjeve ose vlefshmërinë e rezultateve dhe shpërndarjen e mandateve u trajtuan nga Kolegji Zgjedhor me të njëjtin efektivitet që kishte treguar para ditës së zgjedhjeve. Megjithatë, në disa raste Kolegji Zgjedhor nuk arriti të hetonte imtësisht shkakun e çështjes. Për shembull, në rastin e listës së

zgjedhësve në Durrës, Kolegji Zgjedhor mund të kishte lejuar ose kërkuar më shumë prova për të hedhur dritë mbi shkakun e problemeve që u shfaqën në ditën e zgjedhjeve. Në një rast tjetër, Kolegji Zgjedhor vendosi të shpallë të pavlefshme zgjedhjet në 118 nga 345 qendrat e votimit të Tiranës. Gjykimi përmban një mendim pakice dhe, megjithëse vendimi duket të jetë i mirë-argumentuar, Kolegji Zgjedhor mund të kishte urdhëruar hapa të ndërmjetme, të tilla si kërkesa për prova të reja, të cilat mund të kishin çuar në një kuptim më të plotë të shkallës dhe përmbajtjes së problemit.

X. PJESËMARRJA E GRAVE

Pjesëmarrja e grave në politikë ka ardhur vazhdimisht në rënie që prej vitit 1990.¹⁶ Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore e konfirmuan këtë prirje. Vetëm 70 (3.5%) nga 1949 kandidatët për kryetar bashkie ose komune të 384 njësive të qeverisjes vendore ishin gra dhe nga këto u zgjodhën vetëm 10.¹⁷ Partitë politike kryesore përsëri nuk arritën të zbatonin dispozitat e statuteve të tyre në lidhje me kuotat të cilat garantojnë që 25-30% të kandidaturave të jenë femra. Përveç kësaj, raportohet se disa candidate femra janë tërhequr për shkak të presionit nga kryesisht e partive.

Megjithëse disa parti politike pretendojnë anëtarësi të konsiderueshme të femrave edhe në organet e tyre drejtuese, në përgjithësi, gratë nuk kanë pozicione me influencë në parti. Megjithëse ekzistojnë dispozita mbi kuotat e anëtarësisë së grave në organet e disa partive politike, në shumicën e rasteve, ato nuk janë zbatuar plotësisht. Pothuajse të gjithë kandidatët dhe partitë i janë referuar çështjeve të grave në programet e tyre politike dhe disa prej tyre organizuan veprimtari që i kushtoheshin vecanërisht zgjedhëseve femra. Megjithatë, në përgjithësi, çështjet e grave luanjë një rol të vogël në programet e partive, madje edhe në nivel vendor.

U mirëprit fakti që vëmendja e medias mbi çështjet që kishin të bënin me gratë ishte më e madhe se në zgjedhjet e mëparshme dhe disa artikuj e programe u fokusuan në problemet e hasura nga gratë në zgjedhje dhe, më përgjithësisht, në jetën politike. Janë transmetuar, gjithashtu, spote të edukimit të zgjedhësve që inkurajonin pjesëmarrjen e grave në zgjedhje.

Ka patur përmirësime në pjesëmarrjen e grave në administratën zgjedhore, veçanërisht në anëtarësinë në KQV-të, që është rritur nga 8 përqind në vitin 2001 në rreth 23 përqind në këto zgjedhje. Sidoqoftë, vetëm një në shtatë anëtarë të KQZ-së dhe dy nga shtatë anëtarë të BMM-së janë gra.

Ditën e zgjedhjeve, niveli i lartë i votimit në grup dhe atij familjar, shprehimisht i ndaluar me ligj, ishte një shqetësim. Në 39 përqind të qendrave të votimit të vizituara nga vëzhguesit e MNVZ-së, u vërejt votimi në grup. Në një rast, një burrë erdhi në një qendër votimi me 15 gra, kërkoj dhe mori 15 fletë votimi dhe u pa të udhëzonte secilën prej tyre për mënyrën se si duhej të votonte.¹⁸

¹⁶ Vetëm nëntë nga 140 deputetët aktualë në Kuvend janë gra. Në qeveri, vetëm një nga 18 ministrat (Integrimi European) dhe katër nga zëvendësministrat janë gra, ndërkohë që të dyja zëvendëskryetaret e Kuvendit janë gra.

¹⁷ Në zgjedhjet vendore të vitit 2000, nëntë gra u zgjodhën si kryetare bashkie ose komune nga 385 njësi të qeverisjes vendore.

¹⁸ Vendimi Nr. 169 i Gjykatës Kushtetuese në vitin 2002 vendosi se votimi familjar përbën baza për

Organizatet e shoqërisë civile luajnë një rol aktiv në çështjet e grave dhe u përfshinë në nxitjen e pjesëmarrjes së grave në këto zgjedhje. Këtu përfshihej organizimi i trajnimeve për gratë në udhëheqje dhe vendimmarrje, fushata për një rritje të pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe jetën politike dhe vëzhgimi në ditën e zgjedhjeve.

XI. PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE NË PROCESIN ZGJEDHOR

Ndërkohëqë egzistojnë disa pakica kombëtare të dallueshme në Shqipëri, niveli i pjesëmarrjes së tyre në procesin zgjedhor nuk ka qenë një çështje e debatit të përgjithshëm. Në këto zgjedhje, nuk u mor asnjë njoftim për diskriminim të drejtpërdrejtë të pakicave të njohura apo për pengesa që dëmtonin pjesëmarrjen e tyre.

Megjithatë, pjesëmarrja e anëtarëve të pakicave kombëtare si kandidatë ose në administratën zgjedhore ishte e kufizuar. Përveç kësaj, pjesëmarrja në votim e zgjedhësve të regjistruar të pakicave kombëtare, veçanërisht romë dhe egjiptiane, ishte shumë e ulët. Ky problem u acarua më tej nga fakti se shumë zgjedhës nga komunitetet e romëve nuk u përfshinë në listat e zgjedhësve dhe, nga ata që ishin të regjistruar, shumë prej tyre nuk kishin dokumente identifikimi të nevojshme për votim. Ka pak të dhëna që partitë politike të kenë trajtuar çështje që përbëjnë shqetësim për pakicat dhe, pavarësisht nga ndihmesa e dhënë nga komuniteti ndërkombëtar, masat për edukimin e zgjedhësve me synim nxitjen e pjesëmarrjes së pakicave në zgjedhje, ishin të pamjaftueshme.

Vazhdon të ketë tension politik në zonën përreth Himarës, ku disa politikanë e mbështetën fushatën e tyre mbi çështje të pakicës greke. Ky tension u përshkallëzua në incidente të dhunshme më 12 tetor dhe gjatë përsëritjes së votimeve më 16 nëntor.

XII. VËZHguesIT VENDORË

Kodi Zgjedhor u njeht vëzhguesve shqiptarë të njëjtat të drejta me ato të vëzhguesve ndërkombëtarë. Megjithatë, në praktikë, disa vëzhgues vendorë kanë raportuar se hasën probleme për të hyrë në qendrat e votimit dhe për të marrë kopje të tabelave të rezultateve të numërimit të votave.

Ishte një zhvillim pozitiv fakti që një grup prej 18 organizatash të shoqërisë civile, të mbështetura nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, organizuan një vëzhgim më të plotë se në zgjedhjet e mëparshme, duke dërguar në ditën e zgjedhjeve rreth 2200 vëzhgues në 40 për qind të qendrave të votimit të vizituara nga vëzhguesit e MNVZ-së. Për herë të parë, shumica e këtyre organizatave bashkëpunuan nën ombrellën e një grupi të vetëm, Forumi i Vëzhguesve Vendorë, i kryesuar nga ish-kryetari i KQZ-së. Në kuadrin e një projekti të Prezencës së OSBE-së për zhvillimin e formave të bashkëpunimit dhe metodologjive të përbashkëta, ky grup i kushtoi vëmendje të veçantë çështjes të përkatësisë gjinore dhe personave me aftësi të kufizuar. Në ditën pas zgjedhjeve të 12 tetorit, ky grup doli në një konferencë të përbashkët për shtyp dhe nxori një raport përmbledhës mbi zgjedhjet, që, përgjithësisht, ishte në një linjë me vlerësimet e MNVZ-së.

Gjatë zgjedhjeve të përsëritura në Tiranë më 28 dhjetor, organizatat e shoqërisë civile dërguan 50 ekipe vëzhgimi në një përpjekje të parë të madhe vendase dhe të lavdërueshme për të vëzhguar zgjedhjet mbi baza vullnetare, të pavarur nga kontributet e donatorëve të huaj.

XIII. VËZHGIMI I VOTIMIT DHE NUMËRIMIT

A. VOTIMI

Një shkëputje e dukshme dhe e mirëpritur prej praktikës së kaluar ishte fakti që policia u udhëzua të qëndronte larg qendrave të votimit ditën e zgjedhjeve, përveç rasteve kur thirrej me një kërkesë me shkrim nga KQV-ja për të ndërhyrë dhe trajtuar një problem të rendin publik. Në përgjithësi, ky udhëzim u zbatua dhe policia nuk ishte e pranishme në afërsi të qendrave të votimit. Kjo ndikoi pozitivisht në atmosferën e ditës së zgjedhjeve dhe pati shumë më pak pretendime se më parë për ndërhyrje të policisë në procesin zgjedhor ditën e zgjedhjeve.

Votimi ditën e zgjedhjeve u vlerësua pozitivisht nga vëzhguesit e MNVZ-së në 88 përqind të qendrave të votimit të vëzhguara. Ndërsa votimi vijoi përgjithësisht i qetë, pati raportime për tensione dhe konflikte në 9 përqind të qendrave të votimit, ndonëse kjo shkaktohej shpesh nga përshtjellimi i krijuar nga zgjedhësit që nuk mundën të gjenin emrat në listën e zgjedhësve, gjë që u vërejt në mbi 70 përqind të qendrave të votimit të vizituara nga vëzhguesit e MNVZ-së. Për fat të keq, ndodhi një numër i vogël incidentesh të dhunshme, veçanërisht në Himarë, ku problemet në lidhje me zgjedhjet përfshinë edhe shpërthimin e një lënde plasëse në një qendër votimi, duke i shkakuar plagë të lehta një punonjësi policie.

Në Vaun e Dejës (Shkodër) dhe Lurë (Dibër), votimi nuk u zhvillua për faktin se bllokimi politik i KZQV-së pengoi hapjen e qendrave të votimit. Në Durrës, pati vonesa të shumta në fillimin e votimit për shkak të zëvendësimeve në minutën e fundit të anëtarëve të KQV-ve që përfaqësonin PD-në. Votimi, gjithashtu, u ndërpre në disa qendra votimi në rang vendi, për shkak se kutitë e votimit nuk ishin të mëdha sa duhet që të mbanin të gjitha fletët e votimit. Problemi ishte më i madh në Tiranë, gje që çoi në vendimin e KQZ-së për të zgjatur me një orë afatin e votimit në kryeqytet. Disa KQV raportuan se kishin marrë sasi të pamjaftueshme fletësh votimi dhe, në të paktën dy raste, votimi përfundoi në orët e para të pasdites, sepse KQV-ja pretendoi se i ishin mbaruar fletët e votimit, duke lënë disa zgjedhës në pamundësi për të votuar. Më shumë se një e katërta e qendrave të votimit u raportuan të kenë patur pengesa që kufizonin ose pengonin hyrjen e personave me aftësi të kufizuar.

Vëzhguesit e MNVZ-së raportuan se procedurat e votimit në shumicën e rasteve janë ndjekur me korrektesi. Megjithatë, ka patur dështime të dukshme në kontrollimin e timbrosjes me bojë (38%), timbrosjen me bojë (18%) dhe kërkimin e dokumentit të identifikimit të zgjedhësit (14%), të cilat që të gjitha përbëjnë elemente sigurie të rëndësishme kundër votimit të dyfishtë. Shpeshësia e votimit në grup, ose atij familjar, siç është shprehur edhe më lart, ishte, në mënyrë të papranueshme, e lartë.

Në një përmirësim të dukshëm krahasuar me zgjedhjet e mëparshme, vëzhguesit e MNVZ-së raportuan një numër të reduktuar ndjeshëm të personave të paautorizuar (6%) dhe punonjës të policisë (3%) brenda qendrave të votimit. Transparenca e procesit zgjedhor u rrit si rrjedhojë e pranisë së përfaqësuesve të partive politike dhe kandidatëve në 83 përqind të qendrave të votimit

dhe vëzhguesve vendorë jopartiakë në 33 përqind të qendrave të votimit të vëzhguara nga vëzhguesit e MNVZ-së.

B. NUMËRIMI

Vëshguesit e MNVZ-së vërejtën probleme serioze pas mbylljes së votimit. Një vlerësim negativ për procesin e numërimit u raportua në 38 përqind të qendrave të votimit ku u vëzhgua numërimi dhe në 43 përqind të qendrave të votimit ku vëzhguesit e MNVZ-së ishin të pranishëm, u vëzhguan gabime serioze procedurale dhe mangësi. Ka patur mosmarrëveshje lidhur me vlefshmërinë e fletëve të votimit në 45 përqind të qendrave të votimit të vëzhguara, duke rezultuar në një raport relativisht të lartë (deri në 15%) të fletëve të votimit të shpallura të pavlefshme. Vëzhguesit e MNVZ-së vërejtën se, në shumicën e këtyre rasteve, fletët e votimit u duk se tregonin qartë synimin e zgjedhësve. Ka patur një nivel të lartë të paqartësisë për numërimin, ku vëzhguesit e MNVZ-së raportojnë se 40 përqind e KQV-ve hasën probleme serioze në përpilimin e tabelave të rezultateve. Nxjerrja me vonesë e udhëzimeve të KQZ-së për numërimin mund të ketë qenë një faktor ndikues në këtë dukuri.

Gjithashtu, vëzhguesit e MNVZ-së dëshmuuan shkallë të ndryshme të falsifikimit të rezultateve në 10 përqind të qendrave të votimit. Pavarësisht nga kërkesa e ligjit për një kuorum, 11 përqind e KQV-ve funksionuan me më pak se katër anëtarë dhe, në 10 përqind të qendrave të votimit, vëzhguesit e MNVZ-së raportuan kërcënim të anëtarëve të KQV-së. Nuk pati raporte të verifikuara për mbushjen e paligjshme të kutive të votimit, por në 19 përqind të qendrave të votimit janë gjetur më shumë fletë votimi krahasuar me numrin e zgjedhësve të regjistruar që kanë votuar.

Në një aspekt pozitiv, numërimi u zhvillua në mënyrë kryesisht transparente, ku të gjithë aspektet e procesit të numërimit ishin të dukshme për anëtarët e KQV-së, përfaqësuesit e partive dhe vëzhguesit në 97 përqind të qendrave të votimit, në të cilat vëzhguesit e MNVZ-së ishin të pranishëm.

C. NXJERRJA E REZULTATEVE

Në Tiranë, mungesa e udhëzimeve të shkruara mbi procedurat që duheshin ndjekur nga KQV-të për dorëzimin e kutive të votimit në KZQV-në e Bashkisë së madhe dhe 11 KZQV-të e njësive bashkiake, çoi në pështjellim dhe vonesa të konsiderueshme, disa edhe të qëllimshme, në transferimin e kutive të votimit. Nxjerrja e rezultateve nga KZQV-ja e Tiranës nuk filloi para datës 16 tetor, tri ditë tej afatit, pasuar nga vonesa të tejzgjatura, të shkaktuara pjesërisht nga dështimi i KQV-ve dhe KZQV-ve të njësive bashkiake për të dorëzuar materialin zgjedhor të kërkuar, si tabelat e rezultateve dhe fletët e votimit. Në disa raste, anëtarët e komisionit dhanë dorëheqjen ose nuk morën pjesë në mbledhjet e komisionit. Megjithatë, problemet kryesisht erdhën si rrjedhojë e bllokimit politik të krijuara nga anëtarë të KZQV-ve, të cilët, pavarësisht nga detyrimi ligjor për të përpunuar shpejt rezultatet, qëllimisht, kërkuan të krijojnë mosmarrëveshje për të vonuar përmbylljen e detyrës së tyre. KQZ-ja, gjithashtu, ngurroi të kërkonte zbatimin e afateve ligjore për përfundimin e procesit të nxjerrjes së rezultateve. Për rrjedhojë, KQZ-ja ndërhyri më 21 tetor dhe mori përsipër përgjegjësinë për nxjerrjen e rezultateve në Tiranë. Megjithatë, as ky hap nuk arriti ta përshejonte procesin. Mosmarrëveshjet vazhduan ndërmjet anëtarëve të KQZ-së dhe nxjerrja e rezultateve u pezullua përkohësisht për shkak të një hetimi nga Prokuroria e Përgjithshme. Rezultatet zyrtare për

Tiranën u shpallën më në fund nga KQZ –ja më 13 nëntor.

Probleme me nxjerrjen e rezultateve u hasën, gjithashtu, edhe në 9 nga 11 njësitë bashkiake të Tiranës dhe në qytete të tjera të mëdha. Për shembull në Durrës, nxjerrja e rezultateve përfundoi brenda afatit, por tabela e rezultateve nuk u miratua me shumicën e cilësuar të kërkuar. Kjo bëri të domosdoshme marrjen e një vendimi nga KQZ-ja, duke pranuar një apelim nga PS-ja për vërtetimin e rezultateve dhe rrëzoi një kundërapelimit të PD-së për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në atë qytet. Vendimi i KQZ-së u la në fuqi nga Kolegji Zgjedhor.

Në vende të tjera në Shqipëri, nxjerrja e rezultateve u krye, përgjithësisht, në mënyrë të rregullt, ku shumica e KZQV-ve i përmbushën detyrimet e tyre brenda afatit prej 48 orësh. Një problem praktik që u has nga shumë KZQV ishte paaftësia e KQZ-së për të përpunuar me efikasitet rikthimin e materialeve zgjedhore, që solli për rrjedhojë pritjen në rradhë deri në 72 orë të disa komisionerëve, për të dorëzuar zyrtarisht tabelat e tyre të rezultateve dhe materialet zgjedhore.

Në vijim të zgjedhjeve të fundit të përsëritura në janar 2004, KQZ-ja vendosi sanksione administrative për 300 anëtarë të komisioneve zgjedhore, kryesisht për ata të përfshirë në KZQV-të dhe KQV-të e Tiranës dhe rreth 240 raste janë nën hetim nga Prokuroria. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri do të monitorojë trajtimin e këtyre rasteve.

D. PUBLIKIMI I REZULTATEVE

Kodi Zgjedhor nuk bën dallim midis rezultateve paraprake dhe atyre përfundimtare dhe afati kohor i përcaktuar për nxjerrjen dhe shpalljen e rezultateve është i gjatë, deri në dy ditë pas zgjedhjeve. Shpallja e rezultateve është objekt i vonësive të mëtejshme, për shkak të kërkesës për marrjen e vendimeve me shumicë të cilësuar dhe për nënshkrimin e tabelave të rezultateve nga kryetari dhe nënkryetari i KZQV-së për të bërë të vlefshëm rezultatin. Në një lëvizje të konsideruar si pozitive, kryetari i KQZ-së propozoi që të bëhej një përpjekje për shpalljen e rezultateve paraprake brenda 25 orëve nga përfundimi i votimit, megjithatë, ky propozim nuk arriti të merrte mbështetjen e nevojshme nga anëtarët e tjerë të KQZ-së.

KQZ-ja shpalli rezultatet zyrtare të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore menjëherë pas miratimit të tyre, por si pasojë e vonësive të hasura nga shumë KZQV në përpilimin e tabelave të rezultateve dhe dorëzimin e materialeve zgjedhore në KQZ, shpallja zyrtare e rezultateve për çdo njësi vendore u vonua. Ky problem ishte veçanërisht shqetësues në Tiranë, për shkak të bllokimit nga ana e shumë anëtarëve të KZQV-ve dhe paaftësisë së tyre.

E. RINUMËRIMET

Pas miratimit fillestar të rezultateve të nxjerra, pranë KZQV-ve u paraqitën një numër i përgjithshëm prej 54 kërkesash për rinumërim të rezultateve të bashkive dhe komunave. Në të paktën një rast (Gosë - Kavajë) KZQV-ja refuzoi një kërkesë për rinumërim edhe pse një gjë e tillë u kërkuar të zhvillohej në përputhje me Kodin Zgjedhor. Kërkesa u bë nga një kandidat i pavarur që nuk ishte përfaqësuar në KZQV. KQZ-ja e rrëzoi vendimin dhe urdhëroi zhvillimin e rinumërimit. Të gjitha rinumërimet u organizuan në prani të një përfaqësuesi të KQZ-së. Në të paktën një rast (Peshkopi), rinumërimi përmbysi rezultatin fillestar.

XIV. ZGJEDHJET E PËRSËRITURA

Ashtu si dhe në zgjedhjet e mëparshme në Shqipëri, disa njësi zgjedhore hasën vështirësi të mëdha në organizimin e zgjedhjeve apo në miratimin e rezultateve. Në total, zgjedhjet u përsëritën në pesë data të ndryshme - 16 nëntor, 7 dhjetor, 14 dhjetor, 28 dhjetor 2003 dhe 25 janar 2004.¹⁹ Me mbylljen e MVZ-së më 24 tetor, monitorimi në të gjitha datat u organizua nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, e mbështetur më 16 nëntor dhe 28 dhjetor nga OSBE/ODIHR-i dhe nga komuniteti diplomatik në vend dhe, më 28 dhjetor, edhe nga KAVRE.

Zgjedhjet e Përsëritura të datës 16 nëntor

Më 16 nëntor, u zhvilluan zgjedhjet në Vaun e Dejës dhe Lurë, ku, më 12 tetor, zgjedhjet nuk u zhvilluan fare për arsye se KZQV-të dështuan në organizimin e tyre. Gjithashtu, zgjedhjet u përsëritën pjesërisht në Himarë, Temal, Fierzë-Pukë, Qafë e Malit, Derjan, Bubq, dhe Tërbuf, në përputhje me vendimet e KQZ-së dhe të Kolegjit Zgjedhor.

Ndërkohë që votimi kaloi i qetë në Lurë dhe Bubq, pati shkelje të përhapura dhe konflikte në qendra votimi në Himarë, Vaun e Dejës dhe Tërbuf, duke përfshirë votim të deleguar, votim të shumëfishtë dhe mbushje të paligjshme të kutive të votimit. Në disa qendra votimi të Himarës, persona të paautorizuar u përfshinë në drejtimin e procesit dhe, në një qendër votimi, policia ishte e pranishme pa patur identifikimin e duhur. Megjithëse policia ishte dëshmitare e një incidenti të goditjes me armë të ftohtë jashtë një qendre votimi në Himarë-fshat, ajo nuk ndërmoi asnjë veprim për të ndaluar agresorin.

Numërimi i votave dhe nxjerrja e rezultateve në Himarë ishte e tensionuar dhe u shënuan incidente të dhunshme dhe mashtrime të hapura. Pa shqyrtuar tabelat origjinale në kutitë e votimit, KZQV-ja e drejtuar nga PS-ja shpalli PS-në fituese. Mbështetur në një ankim të Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, KQZ-ja vendosi të hapë kutitë e votimit për të rishqyrtuar fletët e votimit dhe përfundimisht shpalli fituese PBDNJ-në.

Në Vaun e Dejës, procesi i nxjerrjes së rezultateve u ndërpre dhe KZQV-ja nuk mori asnjë vendim. Kolegji Zgjedhor vendosi t'i ripërsëriste zgjedhjet në tri qendra votimi, të cilat, pas përpjekjesh të dështuara më 14 dhjetor dhe 11 janar, më në fund, u zhvilluan më 25 janar 2004. Më 29 janar, KQZ-ja shpalli rezultatet për Vaun e Dejës, bazuar në bashkimin e rezultateve të dy ditëve të zgjedhjeve, vendim i cili u la në fuqi nga Kolegji Zgjedhor.

Zgjedhjet e Përsëritura të datës 28 dhjetor

Vendimi i Kolegjit Zgjedhor në përgjigje të një apelimi të PD-së, i cili urdhëroi përsëritjen e zgjedhjeve si për kryetarin ashtu edhe për këshillin bashkiak në 118 qendra votimi në Tiranë, u

¹⁹ Më 7 dhjetor, zgjedhjet u mbajtën në dy qendra votimi në komunën e Gruemirës, të rrethit të Malësisë së Madhe, në vijim të një vendimi të Kolegjit Zgjedhor, ndërsa në komunën e Vergosë, në rrethin e Delvinës, u zhvilluan zgjedhje të pjesshme për të zëvendësuar kryetarin që kishte ndërruar jetë, pasi ishte zgjedhur më 12 tetor. Ndërkohë që votimi i pjesshëm në Vergo u krye qetësisht, shkelje të shumta të ligjit dhe incidente të dhunshme të kryera nga anëtarë të KQV-së dhe mbështetësve të tyre u vërejtën në një qendër votimi në Gruemirë nga monitorues të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, të cilëve, në një moment, ju kërkua të ndihmonin në shënimin e fletëve të votimit me të cilat do të mbushej kutia e votimit në mënyrë të paligjshme. Më 14 dhjetor, në vijim të një vendimi të Kolegjit Zgjedhor, u përsëritën zgjedhjet për këshillin bashkiak në një qendër votimi të bashkisë së Shkodrës, të cilat u zhvilluan përgjithësisht në mënyrë paqësore.

bazua në një sërë shkeljesh dhe mangësish procedurale. Megjithatë, pretendimi kryesor i PD-së për parregullsi mbështetej në listat e zgjedhësve. Dr. Berisha vazhdoi të pretendonte se zgjedhësit e PD-së ishin hequr qëllimisht nga listat dhe se të gjithë ata të cilëve u ishte mohuar e drejta e votës në Tiranë duhej të lejoheshin të votonin në zgjedhjet e përsëritura, pavarësisht nëse banonin ose jo në zonat e 118 qendrave të votimit ku do të përsëriteshin zgjedhjet.

Në një sërë takimesh në Tiranë më 17 dhjetor, Ambasadori Barry ritheksoi se provat e paraqitura pranë OSBE/ODIHR-it nuk mbështesnin një pretendim të tillë dhe se rishikimi tërësor i listave të zgjedhësve para 28 dhjetorit ishte sa i pamundur aq dhe në kundërshtim me Kodin Zgjedhor. Megjithatë, KZQV-ja e Tiranës vendosi me votim 4:3 të rishikonte listat e zgjedhësve, duke pranuar një listë emrash të paraqitur nga partitë politike dhe individë. Ky vendim u rrëzua nga KQZ-ja bazuar në një ankesë të PS-së. PD-ja apeloi në Kolegjin Zgjedhor, i cili e la këtë vendim në fuqi. Kështu, listat e zgjedhësve të përdorura më 28 dhjetor ishin listat “përfundimtare” të përdorura më 12 tetor.

Para datës 28 dhjetor, KQZ-ja ndërmoi disa hapa për të zgjidhur një sërë mangësish administrative të vërejtura më 12 tetor, hapa të cilët rezultuan se ishin të vlefshëm. Këto hapa përfshinin nxjerrjen e udhëzimeve të qarta për anëtarët e KQV-ve për procedura të rregullta të dorëzimit të materialeve zgjedhore dhe infomimin e secilit zgjedhës për qendrën e votimit ku ai duhej të votonte. Gjithashtu, u emërua një KZQV e re, e cila ndërmoi hapa për të zgjidhur problemet teknike në mënyrë profesionale.

Votimi u zhvillua, përgjithësisht, në mënyrë të qetë, pa probleme të mëdha, megjithëse pjesëmarrja në votim e raportuar nga KQZ-ja ishte vetëm 27 përqind. Sërish, më shumë probleme u vërejtën gjatë numërimit të votave, duke përfshirë një numër të konsiderueshëm gabimesh procedurale në disa qendra votimi. I parë si një zhvillim pozitiv në krahasim me zgjedhjet e 12 tetorit, anëtarët e KQV-ve nuk përdorën votën bllokuese dhe transferimi i kutive të votimit në KZQV u zhvillua në mënyrë të rregullt. Nxjerrja e rezultateve u krye në mënyrë profesionale nga KZQV-ja dhe të gjitha rezultatet u mbledhën brenda afatit ligjor. Kundër vendimit të KZQV-së për kryetarin e bashkisë nuk u paraqit asnjë ankim. Megjithatë, si KZQV-ja dhe KQZ-ja nuk arritën shumicën e cilësuar 5:2, të nevojshme për të shpallur rezultatin për këshillin bashkiak, për shkak të mosmarrëveshjeve mbi vlefshmërinë e tabelave të rezultateve të gjashtë qendrave të votimit. Kolegji Zgjedhor shqyrtoi çështjen mbi bazën e një apelimi të PS-së dhe shpalli rezultatin përfundimtar më 14 janar 2004, duke përfshirë edhe gjashtë tabelat e kundërshtuara.

XV. REZULTATET E ZGJEDHJEVE

Rezultatet e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore shënojnë një rënie në përqindjen e votave të fituara nga PS-ja krahasuar me zgjedhjet vendore të vitit 2000 dhe ato parlamentare të vitit 2001, megjithëse është e dukshme që PD-ja nuk pati përmirësim në mbështetjen proporcionale krahasuar me zgjedhjet parlamentare të vitit 2001. Gjithsesi, PD-ja arriti fitore domethënëse në konkurimet për kryetarë dhe këshilla në zona jashtë bazës së saj tradicionale dhe atje ku PS-ja ka mbizotëruar më parë, duke përfshirë zona urbane të Tiranës dhe qytete në zonat qendrore dhe jugore të vendit. Fitore të rëndësishme u shënuan edhe nga partitë e vogla dhe, tanimë, në shumë raste, kryetari i bashkisë apo komunes vjen nga një sfond politik i ndryshëm nga ai i partisë që kontrollon shumicën e vendeve në këshill. Është domethënëse fakti që asnjë organ i qeverisjes vendore i sapozgjedhur nuk është bojkotuar. Në aspektin e qeverisjes

vendore, tashmë Shqipëria është një vend më pak i polarizuar politikisht midis veriut dhe jugut.

XVI. REKOMANDIME

Rekomandimet e mëposhtme i paraqiten autoriteteve shqiptare në përpjekje për të përmirësuar procesin zgjedhor. Duhet vërejtur se trajtimi i shumë prej tyre, në veçanti ato lidhur me emërimin dhe funksionimin e administratës zgjedhore, varet nga vullneti politik i forcave kryesore politike pjesëmarrëse në garën zgjedhore.

A. KUADRI LIGJOR²⁰

1. Kodi Zgjedhor duhet ndryshuar në mënyrë që:

- (i) të trajtojë problemet domethënëse të lidhura me emërimin e anëtarëve të KQZ-së, nivelit të mesëm dhe të ulët të komisioneve zgjedhore. Në veçanti:
 - Të sigurohen dispozita kalimtare për të rregulluar radhën e emërimit të anëtarëve të rinj të KQZ-së dhe për të sqaruar rotacionin e mandateve;
 - Kuadri ligjor për emërimin e anëtarëve duhet të jetë i përcaktuar qartë dhe në përputhje me Kushtetutën;
 - Përfaqësimi politik në të gjitha komisionet zgjedhore duhet të jetë më i gjerë për të siguruar që në komisionet zgjedhore të përfaqësohen më shumë parti;
 - Sistemi i emërimit duhet të jetë i qëndrueshëm dhe të sigurojë garanci ndaj avantazhit politik dhe bllokimit të qëllimshëm;
 - Kërkesa për shumicë të cilësuar votimi për marrjen e vendimeve dhe bashkëvendësimet duhet rikonsideruar;
 - Partitë politike duhet të pranojnë se komisionet zgjedhore duhet të funksionojnë me paanësi dhe profesionalizëm pa ndërhyrje nga jashtë dhe se ankesat duhet të ngrihen përmes procedurave përkatëse të ankimit; dhe
 - Anëtarët e komisioneve zgjedhore duhet të pranojnë se ata janë administratorë dhe jo politikanë.
- (ii) të sigurojë afate më realiste për marrjen e vendimeve mbi ankimet dhe apelimet. Vëmendje e duhur i duhet kushtuar kërkesës që një sistem efikas ankimesh dhe apelimesh duhet të japë rezultate të shpejta;
- (iii) të specifikojë të gjitha dispozitat procedurale që gjejnë zbatim në procesin e ankimit dhe apelimet dhe se ato duhet të kenë përparësi ndaj dispozitave procedurale të Kodit Administrativ dhe Kodit të Procedurës Civile. Këto dispozita duhet të kërkojnë që një ankim, kur paraqitet fillimisht, të mbështetet me dokumentacionin e nevojshëm,²¹ që të merret në shqyrtim nga KZQV-ja, KQZ-ja dhe Kolegji Zgjedhor, duke lejuar kështu marrjen e vendimeve brenda afatit të caktuar nga ligji;
- (iv) të eliminohet roli i partive politike në përgatitjen, rishikimin dhe verifikimin e listave të zgjedhësve. Roli i partive politike është monitorimi i të gjitha fazave të procesit për të cilin duhet të sigurohet transparencë e plotë;
- (v) të kufizojë dispozitat për votim të zgjedhësve me vendqëndrim të përkohshëm, në

²⁰ Siç u vu në dukje më parë, ky raport nuk ka për qëllim dhe as duhet interpretuar si një vlerësim zyrtar ose analizë e plotë e Kodit Zgjedhor. Po ashtu, këto rekomandime mund të trajtojnë vetëm mangësi ligjore dhe domethënëse, të vëna re në dispozita ligjore që zbatohen për zgjedhjet vendore. Mungesa e komentimit për ndonjë dispozite të veçantë të Kodit nuk duhet interpretuar si pranimit i asaj dispozite.

²¹ Ose një shpjegim i mjaftueshëm me shkrim, sepse nuk ishte e mundur të shoqërojnë ankimin me dokumentacionin e nevojshëm në momentin e paraqitjes së tij.

- përcaktimin e rasteve përjashtimore, të tilla si trajtimi mjekësor, shërbimi ushtarak ose funksione zgjedhore;
- (vi) të përcaktojë afate të mjaftueshme për lëvrimin tek KQZ-ja të financimive për administrimin e zgjedhjeve dhe fushatën e partive politike;
 - (vii) të përfshijë kërkesa shtesë në kriteret për kandidatët për zgjedhjet e qeverisjes vendore. Për të shmangur konfliktin e interesave, Kodi duhet të kërkojë që një person anëtar i një komisioni zgjedhor të japë dorëheqjen nga pozicioni para se të regjistrohet si kandidat;
 - (v) (viii) të sigurojë bërjen publike të llogarive për mbledhjen e fondeve dhe shpenzimet për fushatat zgjedhore, duke përfshirë edhe ato të kryetarëve të bashkive dhe kandidatëve të pavarur;
 - (ix) të sigurojë që vendndodhja e qendrave të votimit të përcaktohet në kohë të mjaftueshme para shpalljes së listës paraprake të zgjedhësve;
 - (x) të qartësojë kriteret me anë të të cilave një fletë e shënuar votimi konsiderohet e vlefshme ose jo, duke patur si kriter kryesor për vlefshmërinë e fletës së votimit faktin nëse ka një tregues të qartë të shprehjes së vullnetit të votuesit;
 - (xi) të sigurojë se, kur një fletë votimi përmban dy vota të veçanta, pavlefshmëria e njëërës votë nuk pas sjell pavlefshmërinë e tjetrës;
 - (xii) t'u kërkojë KQV-ve të përfundojnë numërimin e votave dhe të transferojnë materialet zgjedhore në KZQV brenda një maksimumi prej dymbëdhjetë orësh;
 - (xiii) t'u kërkojë KZQV-ve të plotësojnë dhe shpallin menjëherë një tabelë paraprake të rezultateve të pasqyruara në tabelën e çdo KQV-je, përpara se të fillojë verifikimin zyrtar të materialeve zgjedhore;
 - (xiv) t'i kërkojë KQZ të shkarkojë dhe zëvendësojë çdo KZQV që nuk arrin të përpilojë tabelën e rezultateve ose të verifikojë brenda 12 orësh nga marrja e tabelës së KQV-së së fundit të asaj njësie zgjedhore;
 - (xv) të thjeshtojë dhe rishikojë procedurat e numërimit për të siguruar efikasitet dhe koherencë. KQZ-ja duhet të nxjerrë udhëzime të qarta dhe të sakta për të ndihmuar anëtarët e KQV-së gjatë numërimit të votave;
 - (xvi) t'u kërkojë KZQV-ve publikimin e rezultateve paraprake të ndara sipas qendrave të votimit brenda 12 orëve nga marrja e tabelës së KQV-së së fundit dhe nga KQZ-ja brenda 24 orëve nga marrja e tabelës së KZQV-së së fundit.
 - (xvii) të qartësojë kriterin për kryerjen e rinumërimit për votimin për kryetar dhe për listat shumëemërore të partive; dhe
 - (xviii) të sigurojë koherencë të afateve dhe të përkufizimeve si dhe qartësi më të madhe të gjuhës së përdorur.

B. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

2. Autoritetet shqiptare duhet të reformojnë dhe modernizojnë shërbimin e gjendjes civile për të siguruar dhënien në kohë të informacionit për përgatitjen e listave të zgjedhësve. Roli dhe kompetencat e të gjitha organeve të përfshira në këtë proces duhen të qartësohen dhe të shprehen në mënyrë më të detajuar. Përgjegjësia për saktësinë e listave të zgjedhësve duhet të përcaktohet qartë. Duhet të ketë një përpjekje të qëndrueshme e sistematike për të përmirësuar cilësinë dhe saktësinë si të regjistrave të gjendjes civile, ashtu edhe të listave të zgjedhësve.
3. Autoritetet shqiptare duhet të përpilojnë dhe publikojnë harta të sakta për të gjitha zonat e qendrave të votimit dhe njërive zgjedhore. Harta të tilla, së bashku me të dhëna të besueshme të regjistrave të gjendjes civile, duke përfshirë edhe adresat, janë baza parësore

për lista zgjedhësish të sakta.

4. Autoritetet shqiptare duhet të ndërmarrin një shqyrtim të hollësishëm të sistemit për rishikimin dhe publikimin e listave të zgjedhësve. Në veçanti, ligji duhet të specifikojë mjetet për sigurimin e njoftimit individual të zgjedhësve për qendrat e votimit në të cilat ata janë regjistruar.
5. KQZ-ja duhet të ndërmarrë një shqyrtim të hollësishëm të përgatitjeve të saj për zgjedhjet dhe të sigurojë që vendime dhe udhëzime për çështje të rëndësishme, si procedurat e votimit dhe numërimin, të merren dhe shpërndahen me përparësi. Gjithashtu, duhet të ndërmerret një rishikim i dhënies së fondeve KZQV-ve.
6. KQZ-ja duhet të miratojë rregullat proceduriale që i mundësojnë asaj të funksionojë me më shumë efektshmëri dhe të cilat, *inter alia* [ndër të tjera], duhet të lejojnë debatin e hapur, por duke parandaluar vonesa të tepruara.
7. KQZ-ja duhet të nxjerrë udhëzime për marrjen parasysh të aksesit në qendrat e votimit nga personat me aftësi të kufizuar, pasi shumë prej anëtarëve të komisioneve zgjedhore nuk janë të ndërgjegjësuar se kjo duhet marrë parasysh në përzgjedhjen e vendndodhjes së qendrës së votimit. Administratorët zgjedhorë duhet të sigurojnë që dispozitat për votimin e asistuar të respektohen.
8. KQZ-ja duhet të bëjë përpjekje për të siguruar që procedurat e kontrollimit të identitetit dhe timbrosja me bojë zbatohen me efektshmëri. Që të parandalohet me efikasitet votimi i dyfishtë, zgjedhësi duhet të kontrollohet për shenjën e bojës para se të marrë fletën e votimit.
9. KQZ-ja duhet të rishqyrtojë formatin e tabelave të rezultateve për të siguruar qartësi më të madhe të formatit dhe përmbajtjes. Tabela origjinale që do të përdoret për nxjerrjen e rezultateve duhet të jetë qartësisht e dallueshme nga kopjet.
10. KQZ-ja duhet të sigurojë procedura udhëzuese për votimin, numërimin dhe nxjerrjen e rezultateve në konkurimet e ndryshme zgjedhore për qeverisjen vendore, që zhvillohen në Tiranë dhe në njësitë e saj bashkiake dhe në çdo rast tjetër kur përdoret më shumë se një kuti votimi.
11. KQZ-së duhet t'i jepet një ndërtesë e përhershme e pajisur në mënyrë të përshtatshme.
12. Kërkesa që sekretari i KZQV-së të jetë një jurist i kualifikuar duhet të rikonsiderohet.
13. Partitë politike nuk duhet të kenë të drejtën të zëvendësojnë anëtarë të KQV-ve pas emërimit të tyre në detyrë. Kriteria kualifikuese duhet të përcaktohen për anëtarët e komisioneve, duke përfshirë plotësimin e kërkesave për trajnim.
14. Përdorimi i telefonave celularë gjatë procesit të votimit, numërimin dhe nxjerrjes së rezultatit duhet të ndalohet.
15. Roli i KQZ-së në procesin e regjistrimit të kandidatëve për zgjedhjet në qeverisjen vendore duhet të qartësohet.

16. Përdorimi i fletës së votimit “dyshe” duhet të rikonsiderohet. Të paktën, Kodi duhet të përshkruajë me hollësi se si duhet ta vlerësojë komisioni i qendrës së votimit një fletë votimi që përmban një votë të vlefshme dhe një të pavlefshme në të njëjtën fletë votimi.
17. Prokuroria, në përgjigje të raportimeve nga administratorët e zgjedhjeve, duhet të nisë menjëherë procedime penale kundër atyre që shkelin legjislacionin zgjedhor. Kjo duhet të gjejë zbatim, veçanërisht për anëtarët e komisioneve zgjedhore që pengojnë zhvillimin e votimit ose bllokojnë procesin e nxjerrjes së rezultateve. Palët e dëmtuara duhet të përdorin dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe Kodit Penal kundër atyre që kryejnë mashtrime zgjedhore.

C. ANKIMET DHE APELIMET

18. Të gjitha palët e interesuara në procesin zgjedhor duhet të angazhohen për respektimin e procedurave aktuale për paraqitjen e ankimeve apo apelimeve. KQZ-ja duhet të mos pranojë të marrë në shqyrtim një ankim që nuk është paraqitur zyrtarisht. Komisioneve të nivelit të mesëm duhet t’u kërkohet të vendosin për ankimet e bëra pranë tyre dhe mosgjykimi i një ankimi brenda afatit duhet konsideruar si rrëzim i tij, duke krijuar kështu bazën për apelim.

D. MEDIA

19. Kuadri ligjor për shpërndarjen e kohës falas të transmetimit për partitë politike duhet qartësuar lidhur me çështjen e nivelit të pasqyrimin për partitë e vogla parlamentare, për të siguruar respektimin e synimit të legjislatorit.
20. Anëtarët e BMM-së duhet të caktohen mbi baza jopartiake, ku kriteret e emërimit të kërkohen ekspertizë teknike në media dhe çështje analitike.
21. Kërkesa që KZQV-të të vendosin një monitorim të medias lokale duhet hequr ose ndryshuar për të lejuar zbatimin në praktikë.

E. PJESËMARRJA E GRAVE

22. Autoritetet shqiptare dhe partitë politike duhet të ndërmarrin hapa për të nxitur pjesëmarrje më të madhe të grave në të gjitha aspektet e jetës politike, duke përfshirë edhe administratën zgjedhore.
23. KQZ-ja duhet të ndërmarrë hapa, përfshirë këtu trajnimin për ndërgjegjësim lidhur me përkatësinë gjinore, për të parandaluar votimin në grup dhe atë familjar. Duke patur parasysh mungesën e ndërgjegjësimin për seriozitetin e kësaj shkeljeje, trajnimi duhet të theksojë se votimi familjar përbën një mohim faktik të së drejtës për të votuar.

F. VËZHGIMI VENDOR

24. Vëzhgimi vendor duhet të inkurajohet dhe komuniteti ndërkombëtar duhet të vazhdojë të sigurojë asistencë për zgjerimin e kapaciteteve të grupeve përkatëse vëzhguese.

RRETH OSBE/ODIHR-IT

Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) është institucioni kryesor i OSBE-së që ndihmon shtetet pjesëmarrëse “të sigurojnë respektim të plotë të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, shtetit të së drejtës dhe për të promovuar parimet e demokracisë dhe (...) për të ndërtuar, forcuar dhe mbrojtur institucionet demokratike, si dhe të promovojë tolerancën në të gjitha nivelet e shoqërisë” (Dokumenti i Helsinkit 1992).

ODIHR-i, me seli në Varshavë, Poloni, u krijua si Zyra për Zgjedhje të Lira në Samitin e Parisit në vitin 1990 dhe filloi funksionimin në maj 1991. Një vit më vonë, emri i Zyrës u ndryshua për të pasqyruar një mandat më të gjerë për të përfshirë të drejtat e njeriut dhe demokratizimin. Sot, për të punojnë mbi 100 vetë.

ODIHR-i është organizmi kryesor në Europë në fushën e **vëzhgimit të zgjedhjeve**. Ai bashkërendon dhe organizon dërgimin e mijëra vëzhguesve çdo vit për të vlerësuar nëse zgjedhjet në zonën e OSBE-së janë në përputhje me legjislacionin vendas dhe standartet ndërkombëtare. Metodologjia unike siguron një vështtrim në thellësi të të gjithë elementëve të një procesi zgjedhor. Me anë të projekteve të asistencës, ODIHR-i ndihmon shtetet pjesëmarrëse të përmirësojnë kuadrin e tyre zgjedhor.

Veprimtaritë e Zyrës për **demokratizim** përfshijnë fushat tematike të mëposhtme: shteti i së drejtës, shoqëria civile, liria e lëvizjes, barazia gjinore dhe trafikimi i qenieve njerëzore. ODIHR-i zbaton një numër programesh të caktuara asistence çdo vit, duke kërkuar si lehtësimin ashtu edhe mbështetjen në përmbushjen e angazhimeve të OSBE-së nga vendi pjesëmarrës dhe të zhvillojë struktura demokratike.

ODIHR-i monitoron shtetet pjesëmarrëse në përmbushjen e angazhimeve të OSBE-së lidhur me dimensionin njerëzor dhe ndihmon në përmirësimin e të **drejtave të njeriut**. Gjithashtu, organizon disa takime çdo vit për të rishikuar zbatimin e angazhimeve të OSBE-së lidhur me dimensionin njerëzor nga shtetet pjesëmarrëse.

ODIHR-i këshillon shtetet pjesëmarrëse mbi politikat e tyre për komunitetet **rome dhe sinti**. Zyra nxit rritjen e kapaciteteve dhe lidhjen në rrjet mes komuniteteve rome dhe sinti, si dhe pjesëmarrjen e përfqësuesve romë dhe sinti në organet politikëbërëse. Zyra punon, gjithashtu, për shkëmbimin e informacionit mbi çështjet rome dhe sinti midis aktorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Të gjitha veprimtaritë e ODIHR-it zhvillohen në bashkëpunim dhe bashkërendim të ngushtë me shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, institucionet dhe veprimet në terren të OSBE-së, si dhe me organizma të tjerë ndërkombëtarë.

Informacione të mëtejshme mund tëI gjeni në faqen e internetit të ODIHR-it (www.osce.org/odihhr).